REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

MINISTRIA E SHENDETSISË
NR 1503/44 Prot
10.02.2016

KONTRATË KONÇESIONI
PËR SHËRBIMIN E HEMODIALIZËS

Ndërmjet

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Dhe

SHOQËRISË TREGTARE DIAVITA SHPK

Tiranë, 10 Shkurt 2016

Përmbajtja

Nr.	Titulli Nenet	Faqja
1.	Përkufizimet dhe interpretimi	7
2.	Kujdesi i duhur	9
3.	Dhënia e Koncesionit	10
4.	Plani i Projektit.	15
5.	Testimi.	16
6.	Vonesat në zbatim – Dispozita të Përgjithshme.	16
7.	Vonesat për Shkak të Pazotësisë së Koncesionarit	18
8.	Vonesat në arritjen e Pikësynimeve për Shkak të Autoritetit.	19
9.	Shërbimet	20
10.	Nivelet e Shërbimit.	21
11.	Pasoja e Mospërmbushjes nga ana e Autoritetit në Fazën Operacionale	22
12.	Standardet.	23
13.	Garantimi i Cilësisë.	23
14.	Përmirësimi i Shërbimeve.	24
15.	Sistemi dhe Siguria.	25
16.	Çështje financiare.	26
16.4	Financimi i Koncesionit.	27
17.	Taksat	27
18.	Përfaqësuesit.	28
19.	Rregullimi.	28
20.	Nënkontraktimi.	28
21.	Rishikimi i Shërbimit.	29
22.	Kontrollet.	29

23.	Regjistra dhe Raporte.	30
24.	Procedura e Ndryshimit të Kontratës.	30
25.	Personeli.	31
26.	Detyrimet e marra përsipër nga Koncesionari.	31
27.	Mirëmbajtja dhe riinvestimi.	32
28.	Shëndeti dhe siguria.	33
29.	Barazia dhe Diversiteti.	33
30.	Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale.	33
31.	Licencat e dhëna nga Koncesionari.	33
32.	Licencat e dhëna nga Autoriteti.	33
33.	Përcaktimi i IPR-ve në Bazën e të Dhënave.	34
34.	Përcaktimi i IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe i Programeve kompjuterike të Shkruar Posaçërisht	35
35.	Të dhënat e Autoritetit.	35
36.	Mbrojtja e të Dhënave Personale.	36
37.	Detyrime të Posaçme të Autoritetit.	37
38.	Detyrime të Përgjithshme të Autoritetit.	38
39	Plani i Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda	39
40	Forca Madhore – *Force Majeure*	39
41	Dëmshpërblimi.	40
42	Konfidencialiteti.	41
43	Kufizimet në Përgjegjësi	42
44	Sigurimi.	43
45	Detyrimet për Burime, Licencë dhe Bashkëpunim të Koncesionarit	43
46	Garancitë.	44
47	Siguria e Sistemit	45
48	Të drejtat dhe Detyrimet e Koncesionarit.	46
49	Zgjidhja.	48

50	Pasojat e Zgjidhjes.	49
51	Administrimi i Daljes.	50
52	Të drejtat për Ndërhyrje.	50
53	Sigurimi i Kontratës.	51
54	Transferimi.	51
55	Çlirimi dhe rregullimet kumulative.	52
56	Marrëveshja e Palëve.	52
57	Parandalimi i korrupsionit.	52
58	Publiciteti.	53
59	Pavlefshmëria e pjesshme.	53
60	Sigurime të mëtejshme.	53
61	Marrëveshja si një e tërë.	53
62	Të drejtat e Palëve të Treta.	54
63	Njoftimet.	54
64	Gjuha dhe Kopjet.	54
65.	Ligji rregullues dhe Juridiksioni.	54

ANEKSE

Aneksi 1	Përkufizimet
Aneksi 2	Kërkesat e Autoritetit
Aneksi 3	Propozimi i Koncesionarit
Aneksi 4	Lista e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve mjekësore dhe jomjekësore sipas specifikimeve teknike të dakortësuara, së bashku me ndryshimet
Aneksi 5	Nivelet e Shërbimit dhe Plani i zbatimit
Aneksi 6	Plani i Testimit
Aneksi 7	Çështje financiare
Aneksi 8	Personeli Kryesor
Aneksi 9	Procesverbali i dorëzimit
Aneksi 10	Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve
Aneksi 11	Procedura e Ndryshimeve të Kontratës
Aneksi 12	Kontrata e financimit nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm
Aneksi 13	Protokolli i Hemodializës
Aneksi 14	Planimetritë e Truallit apo Sipërfaqeve që po Merren në Përdorim nga Koncesionari për t'u Ndërtuar apo Shfrytëzuar

KJO KONTRATË nënshkruhet më 10 Shkurt 2016 në Tiranë, Shqipëri

NDËRMJET:

Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë (në vazhdim referuar si **"Autoriteti")** e caktuar si e tillë ne Gërmën (a), Pika 2, Neni 13 te Ligjit Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", përfaqësuar nga Z. Ilir Beqja, i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllimet e këtushme në cilësinë e tij si Ministër i Shëndetësisë,

DHE

DiaVita Sh.p.k. (në vazhdim referuar si **"Konçencionari" ose "Shoqëria Koncesionare"**) person juridik shqiptar i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërisë Tregtare" dhe të ligjit nr. 125/2013 "Për Konçencionet dhe Partneritetin Publik Privat", identifikuar me numër NIPTL52305009L,me seli të regjistruar në adresën Autostrada Tirane-Durres, Km 8, Rruga Paralele, Ndertese Private, KasharTiranë, Shqipëri,përfaqësuar në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, nga ana e Administratorit të saj Znj. Marsida Hoxha,person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

DEKLARIME PARAPRAKE

Në përputhje me sa vijon:

- Ligjin Nr. 125/2013 "*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*"; i ndryshuar
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.308, datë 21.05.2014 *"Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor"*;

Secila prej palëve është e autorizuar që të nënshkruajë këtë Kontratë;

DUKE QENËSE:

(A) Autoriteti, duke e konsideruar ofrimin e shërbimit të hemodializës në 5 qendra pranë spitaleve përkatësisht në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan të një rendësie të veçantë i cili ka për qëllim përmirësimin, ndërtimin dhe rinovimin e ambienteve bazuar në standardet më të larta dhe ofrimin e shërbimit sa më pranë qendrave të banimit të pacientëve.

(B) Autoriteti ka publikuar mëdatë21.05.2015, Dokumentat e Proçedurës së Konkurrimit për dhënien e Konçesionit "Për ofrimin e shërbimit të hemodializës", në 5 qendra pranë

spitaleve rajonalë Lezhë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Korçë, këtu bashkangjitur si Aneksi 2 i kësaj Kontrate;

(C) Meqënëse Shoqëria Evita sh.p.k dhe Shoqëria American Hospital, ortak të Koncesionarit, në cilësinë e Ofertuesit kanë paraqitur më datë 03.08.2015 propozimin e tyre në përgjigje të procedurës konkurruese për "Ofrimin e shërbimit të hemodializës në 5 qendra pranë spitaleve përkatësisht në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan", këtu bashkangjitur si Aneksi 3 i kësaj Kontrate, propozim i cili është pranuar nga Autoriteti;

(D) Autoriteti i ka dërguar Koncesionarit më datë 01.10.2015 "Njoftimin e Fituesit", (Dokumenti Nr 1503/30 prot.) duke pranuar propozimin e paraqitur nga Koncesionari dhe duke caktuar këtë koncesion ndaj këtij Koncesionari;

(E) Autoriteti dhe Koncesionari përfshihen në këtë Kontratë me qëllimin për të vënë në jetë koncesionin në përputhje me afatet dhe dispozitat e përcaktuara në këtë dokument dhe dokumente të tjera bashkëlidhur;

(F) Palët njohin faktin që ky projekt dhe dhënia e Koncesionit është e një rëndësie publike kombëtare dhe se afatet kohore për ofrimin e shërbimeve te kërkuara janë tepër të rëndësishme. Palët njohin dhe pranojnë faktin që plotësimi në kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e tyre i detyrimeve që ato kanë dhe bashkëpunimi e ndihmesa më e gjerë me Palën tjetër siç përcaktohet me hollësi në këtë Kontratë është thelbësore për vënien në jetë të projektit.

ATËHERË:

Palët e mësipërme bien dakord si vijon:

DISPOZITA OPERATIVE:

1. Përkufizimet dhe interpretimi

1.1 Në këtë Kontratë, do të zbatohen përkufizimet e paraqitura në Ankesin 1 (**Përkufizime**).

1.2 Në këtë Kontratë, përveçse kur përmbajtja kërkon ndryshe:

1.2.1 Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;

1.2.2 Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe/ose atë neutrale;

1.2.3 Referimi tek një Ligj, dispozitë ligjore apo instrument ligjor përfshin referimin tek ai Ligj, dispozitë ligjore apo instrument ligjor siç është ndryshuar, zgjeruar apo rimiratuar kohë pas kohe dhe tek çdo Vendim i Këshillit të Ministrave i nxjerrë sipas tij. Pasoja e çfarëdo ndryshimi, zgjerimi apo rimiratimi të tillë mbi këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me Nenin 24 (Kontrolli i

Ndryshimit). Në rast se pasojat mbi këtë Kontratë të ndryshimit, zgjerimit ose rimiratimit të Ligjit nuk janë zgjidhur mbi bazën e nenit të mësipërm, Kontrata interpretohet sikur ndryshimi, zgjerimi ose rimiratimi ligjor nuk ka asnjë efekt mbi këtë të fundit e cila vazhdon të zbatohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në momentin e nënshkrimit të Kontratës;

1.2.4 Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull" apo të ngjashme, do të kuptohen si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;

1.2.5 Referimet tek një person përfshijnë një shoqëri, korporatë dhe shoqatë apo ent ligjor të paregjistruar apo të bashkuar;

1.2.6 Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nënparagrafët, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë interpretimin e kësaj Kontrate;

1.2.7 Referimet tek çdo kontratë ose instrument janë për atë kontratë ose instrument siç janë ndryshuar, shtuar, modifikuar ose zëvendësuar kohë pas kohe; dhe

1.2.8 Një referim tek secili organ është:

(i) Nëse ai organ zëvendësohet nga një organ tjetër, vlerësohet se i referohet zëvendësuesit të tij; dhe

(ii) Nëse ai organ pushon së ekzistuari, vlerësohet se i referohet organit që është më afër ose që në shkallën më të lartë të hierarkisë shërben për të njëjtat qëllime ose objekte sikurse ai organ.

1.3 Referimet në dispozitat dhe Anekset janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat edhe anekset e kësaj Kontrate.

1.4 Nëse në ndonjë rast apo rrethanë, ka ndonjë konflikt ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojce të Anekseve dhe/ose çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti do të zgjidhet në përputhje me rendin e mëposhtëm të precedencës:

1.4.1 Aneksi 4 (Lista e ndryshimeve të dakordësuara ndaj Aneksit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Aneksit 3 (Propozimi i Koncesionarit));

Shënim: Nëse një përmirësim apo sqarim nuk deklarohet në Aneksin 4 (Lista e ndryshimeve të rëna dakord ndaj Aneksit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Aneksit 3 (Propozimi i Koncesionarit) atëherë në të gjitha situatat do të ketë përparësi Aneksi 2 si deklarimi thelbësor i Kërkesave të Autoritetit që duhet të përmbushë Koncesionari

1.4.2 Aneksi 2 (Kërkesat e Autoritetit);

1.4.3 Aneksi 3 (Propozimi i Koncesionarit);

1.4.4 Nenet e kësaj Kontrate dhe Aneksi 1 (Përkufizime);

1.4.5 Aneksi 5 (Nivelet e Shërbimit dhe Plani i Zbatimit);

1.4.6 Aneksi 7(Çështje financiare);

1.4.7 Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre; dhe

1.4.8 Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkangjitur më këtë Kontratë.

1.5 Mbi bazën e dispozitave të Neneve 6 deri në 9 (përfshirë), asnjë Palë e kësaj Kontrate nuk do të jetë përgjegjëse për paaftësinë e përmbushjes së detyrimeve të saj bazuar në këtë Kontratë deri në masën që kjo paaftësi është shkaktuar nga një dështim ose vonesë shkaktuar nga Pala tjetër në realizimin e detyrimeve të saj bazuar në këtë Kontratë. Pala e prekur do të njoftojë Palën tjetër për çdodështim apo vonesë të tillë brenda 30 ditëve, në mënyrë të tillë që kjo e fundit të vlerësojë këtë ngjarje dhe efektin e saj të mundshëm dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për riparimin e situatës.

2. Kujdesi i duhur

2.1 Koncesionari njeh dhe pranon që:

2.1.1 ka bërë dhe do të bëjë vlerësimet e tij për të gjitha çështjet përkatëse për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Kontratë, duke përfshirë kërkimin e çdo informacioni të nevojshëm nga Autoriteti në kushtet kur Koncesionari e kërkon për një qëllim të tillë;

2.1.2 ka paraqitur çdo kërkesë të arsyeshme përpara Autoritetit dhe ka treguar kujdesin e duhur ndaj zbatimit të këtij Projekti përpara Datës së fillimit të afatit të Koncesionit;

2.1.3 është ndërgjegjësuar përsa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Politikave të Autoritetit të referuara në Aneksin 2 (Kërkesat e Autoritetit), Aneksi 3 (Propozimi i Koncesionarit); dhe Aneksi 4 në rast se zbatohet; dhe

2.1.4 ka të gjithë njohurinë, të drejtat, pajisjet, programet kompjuterike, sistemet dhe personelin e nevojshëm me qëllim që t'i japë mundësi atij të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë, duke përfshirë mundësinë për të përmbushur dhe realizuar kërkesat e Propozimit të Koncesionarit.

2.2 Pavarësisht nga sa më sipër, çështjet dhe procedurat administrative për përmbushjen e çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate që kërkon miratimin, vendimmarrjen ose pjesëmarrjen e organeve shtetërore ose vendore konsiderohen që janë jashtë kontrollit dhe vlerësimit të Koncesionarit.

2.3 Autoriteti njeh, pranon dhe garanton që të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion të Koncesionarit me shkrim janë të sakta, të përpikta dhe të vërteta, duke përfshirë këtu Dokumentat e Procedurës Konkurruese dhe se do të ofrojë çdo të dhënë dhe/ose informacion tjetër të mundshëm me kërkesë të Koncesionarit për një zbatim sa më të mirë të këtij Projekti.

3. Dhënia e Koncesionit

3.1 Dhënia e Koncesionit

3.1.1 Duke ju nënshtruar dhe në përputhje më afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë dhe Anekset bashkëlidhur, Autoriteti jep dhe autorizon Koncesionarin për aq sa parashikojnë dokumentat e tenderit dhe kjo kontratë, të planifikojë, të financojë dhe të zbatojë ofrimin e shërbimit të hemodializës, në përputhje me dispozitat e Nenit 3.1.2.

3.1.2 Koncesionari do të sigurojë hartimin, përcaktimin, zhvillimin, zbatimin dhe operimineProjektit i cili do të drejtohet përmes nën-sistemeve të mëposhtme:

Shërbimi i Hemodializës:
Koncesionari do të sigurojë të gjitha mjetet, pajisjet dhe materialet mjekësore dhe jo-mjekësore për ofrimin e shërbimeve te mëposhtme:

- Ofrimin e shërbimit të hemodializës pranë spitaleve rajonale Shkodër, Lezhë, Korçë, Elbasan, Vlorë.
- Rehabilitimii hapësirave ekzistuese në Shkodër, Vlorë dhe Elbasan, rehabilitimi i ambienteve dhe ndërtimi i hapësirave të reja në Korçë dhe Lezhë.
- Pajisja me poste për kryerjen e hemodializës në të pesë qendrat e sipërmendura si dhe me pajisje laboratorike për testet mujore laboratorike.

Kryerja e shërbimit nga Koncesionari konsiston në:

- Rehabilitimin ose ndërtimin sipas kërkesave minimale dhe specifikimeve teknike tëqendrave ku do të kryhet procesi i hemodializës
- Ofrimin e shërbimit të hemodializës, pranë spitaleve rajonale,Shkodër, Lezhë, Korcë, Elbasan, Vlorë.
- Pajisjen me poste për kryerjen e hemodializës sipas projeksioneve të SëmundjeveRenale Kronike.
- Pajisjen me aparatura laboratorike si cellcounter, autoanalizator biokimik dhe analizator imunologjik.

- Staf të kualifikuar sipas kërkesave për kualifikim për të garantuar një shërbim cilësor për të gjithë pacientët që duhet të kryejnë seancën e hemodializës.
- Furnizimin me materialet e nevojshme të sallave dhe makinerive për shërbimin e hemodializës.
- Garantimin e shërbimit të procesit të hemodializës sipas kritereve minimale të cilat konsistojnë në garantimin e dhënies së shërbimit rreth 3 herë në javë ose rreth 156 herë në vit për një pacient.
- Verifikimin e kryerjes së çdo seance dialize sipas kartelës mjekësore.
- Kryerjen e çdo seance sipas protokollit bashkëlidhur këtij dokumenti, Aneksi 13.
- Dixhitalizimin e menaxhimit, ndjekjes dhe raportimit të aktiviteteve të kontraktuara.

Koncesionari do të angazhohet për të kryer trajnimin e stafit përpara fillimit të ofrimit të këtij shërbimi.

Koncesionari ka detyrimin të krijojë brenda hapësirës së ofruar për shërbimin e hemodializës, laboratorë në çdo qendër, për kryerjen e analizave të detyrueshme për pacientët sipas protokollit të hemodializës bashkëlidhur në Aneksin 13.

Koncesionari në përfundim të periudhës 10 vjeçare të Koncesionit, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues të gjitha asetet e përdorura dhe pajisjet e tjera të cilat do të përdoren në funksion të këtij shërbimi.

Koncesionari për të kryer shërbimin e kërkuar, do të përshtatet me planifikimet shtesë të kërkuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor/FSDKSH për rastet e reja.

Koncesionari do të hartojë planin e veprimit ditor për grumbullimin e mbetjeve spitalore.

3.2 Periudha e Koncesionit

Koncesioni jepet për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh duke filluar nga Data e fillimit të afatit të Konçesionit dhe përfundon në datën e përvjetorit të 10-të të kësaj date ("Periudha Efektive").

3.3 Mekanizmat e Zgjatjes së Periudhës Koncesionare

3.3.1 Periudha e Koncesionit do të shtyhet në rast të Forcës Madhore për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia për të përmbushur detyrimet.

3.3.2 Palët bien dakord që Periudha e Koncesionit do të zgjatet për një periudhë që pasqyron periudhën kohore në të cilën Autoriteti ose organi shtetëror ose vendor kompetent shkakton një vonesë në përftimin e një license, leje apo autorizimi të kërkuar për përmbushjen e ndonjë detyrimi nga ana e

Koncesionarit që rrjedh nga dhe/ose është e lidhur me këtë Kontratë, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenin 3.8.1(iii).

3.3.3 Përveç sa më sipër, Palët janë dakord që Periudha e Koncesionit do të zgjatet për periudhën e kohës gjatë të cilës një vonesë tjetëre Autoritetit ose e ndonjë organi shtetëror ose vendor kompetent shkakton ndonjë vonesë tek Koncesionari në përmbushjen e detyrimeve të tij.

3.3.4 Ndryshime në kuadrin ligjor në fuqi të cilat ndikojnë në realizimin e kontratës së koncensionit në afat, për periudhën tranzitore të hyrjes në fuqi të ndryshimeve apo për afatin e përcaktuar në kuadrin ligjor.

3.3.5 Çdo zgjatje e afatit të Kontratës mbi bazën e dispozitave të mësipërme do të formalizohet mes palëve nëpërmjet nënshkrimit të një Aneks kontrate.

3.4 Ekskluziviteti dhe preferimi.

3.4.1 Të Drejtat e Koncesionit nuk do të jenë ekskluzive. Megjithatë Autoriteti garanton Koncesionarin se numri i pacientëve dhe seancave gjatë gjithë periudhës së Koncesionit nuk do të jetë më i ulët se projeksioni i përcaktuar në DST.

3.4.2 Në rast se gjatë një muaji të caktuar pas fillimit të afatit të Koncesionit Autoriteti nuk arrin të përmbushë detyrimin për të garantuar numrin minimal të pacientëve dhe seancave sipas projeksionit të DST, atëherë ai dëmshpërblen Koncesionarin me diferencën midis vlerës së garantuar për të cilën është kërkuar edhe investimi në numër makinerish dhe asaj të paguar ose që do paguhet efektivisht sipas numrit të pacientëve të trajtuar në muajin përkatës.

3.5 Autorizime, Leje dhe Licenca.

3.5.1 Autoriteti do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të asistuar Koncesionarin në raport me çdo Ent Shtetëror ose Vendor në lëshimin e autorizimeve, licensave dhe lejeve për zbatimin e Koncesionit, me kusht që Koncesionari në çdo rast të ketë përmbushur kërkesat ligjore për aplikimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve të tilla. Në rast se Enti Shtetëror ose Vendor Kompetent, në mënyrë të paarsyeshme refuzon lëshimin e autorizimeve/licensave dhe lejeve, Koncensionari do të zhvishet nga çfarëdolloj përgjegjësie dhe ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim kundrejt Autoritetit.

3.5.2 Deri në masën që Autoriteti ose çdo Enti Shtetëror (i cili është nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Autoritetit) ka të drejtë të lëshojë autorizime, Autoriteti do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të asistuar dhe siguruar që autorizimet, lejet dhe liçencat t'i lëshohen

Koncesionarit në përputhje me këtë Kontratë dhe Ligjin e Zbatueshëm, pa vonesa të paarsyeshme me kusht që Koncesionari në çdo rast të ketë përmbushur kërkesat ligjore për aplikimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve të tilla.

3.5.3 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e duhura për të mundësuar që të gjitha Entet Shtetërore ose Vendore që ushtrojnë autoritetin e tyre përkatës në lidhje me Koncesionin të jenë të informuara në mënyrën e duhur në lidhje me ekzistencën e kësaj Kontrate dhe si rrjedhojë të bashkëpunojnë pa vonesa të paarsyeshme me Koncesionarin në lidhje me zbatimin e Koncesionit.

3.6 Rikthimi/Dorëzimi i Pajisjeve, materialeve dhe Mjeteve të Koncesionit.

3.6.1 Me mbarimin e Periudhës së Koncesionit ose zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit e konstatuar me vendim sipas nenit 65, Koncesionari do të rikthejë posedimin e lirë dhe të paqtë të ambienteve, pajisjeve, materialeve dhe mjeteve mjekësore dhe jomjekësore të furnizuara në qendrat e hemodializës pranë 5 spitaleve rajonale ku është ofruar ky shërbim ndaj Autoritetit në pajtim me Nenin 3.7.

3.6.2 Proçesi i dorëzimit do të fillojë të paktën 1 (një) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Konçesionit ose zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit sipas dispozitave të parashikuara në këtë Marrëveshje. Dorëzimi konstatohet me proces-verbal në vijim të inspektimit përkatës në të cilin marrin pjesë përfaqësues të përbashkët të Autoritetit dhe Koncesionarit.

3.7 Procedura e Dorëzimit.

3.7.1 Palët bien dakord pas të mbarimit të Periudhës së Koncesionit ose zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit sipas nenit të mësipërm, çdo e drejtë apo titull përdorimi i qendrave të ofrimit të shërbimit të hemodializës pranë 5 spitaleve rajonalë, i dhënë Koncesionarit në lidhje me vendndodhjet (mjediset) e në funksion të Koncesionit, nuk do t'i përkasë më dhe Koncesionarit:

(i) do t'i kalojë Autoritetit çdo të drejtë ose titull në lidhje me vendndodhjet, mjetet, pajisjet dhe materialet mjekësore dhe jomjekësore objekt i kontratës së Koncsionit, dhe Sistemin Software që përmban të dhënat e Regjistrit të Hemodializës, duke futur këtu kalimin, përmirësimin dhe/ose transferimin e të gjitha programeve kompjuterike të përdorura në operimin dhe zhvillimin e Sistemit.

(ii) do t'i dorëzojë Autoritetit të gjithë dokumentet dhe të dhënat në posedim të tij në lidhje me të gjitha termat që kanë të bëjnë me operimin e Koncesionit nga Koncesionari pa pagesa, detyrime apo tarifa të mëtejshme.

3.7.2 Autoriteti bie dakord dhe merr përsipër që brenda 30 ditëve nga transferimi i të drejtave, titujve në lidhje me vendndodhjet e Koncesionit, Pasurive të Reja apo Ekzistuese, përfshirë transferimin e të gjithë përbërësve që formojnë Sistemin duke futur këtu kalimin, përmirësimin dhe/ose transferimin e të gjitha programeve kompjuterike të përdorura në operimin dhe zhvillimin e Sistemit deri në momentin e dorëzimit, nga Koncesionari dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse siç është parashikuar në paragrafin (ii) më lart, ai do të lëshojë dhe dërgojë Procesverbalin e Rikthimit të kësaj Kontrate për Koncesionarin.

3.7.3 Koncesionari do të sigurojë që të gjitha pronat, pasuritë, të drejtat dhe artikujt e tjerë të referuara sipas këtij Neni të cilat janë të bashkëngjitura apo të transferuara tek Autoriteti, do të jenë në kushte të mira pune dhe në një gjendje të mirë riparimi, të tilla që Sistemi të jetë në gjendje për të funksionuarnë kushte normale. Në çdo rast Koncesionari nuk merr përsipër çfarëdo detyrimi garancie përtej afatit të përfundimit të Periudhës së Koncesionit, pasi dhe garancitë i transferohen Autoritetit.

3.7.4 Të gjitha strukturat e tjera apo asetet të cilat nuk janë vënë në dispozicion nga Autoriteti, por që Koncesionari i ka ngritur për të mundësuar efektshmëri të shërbimit, ku përfshihen të gjitha laboratorët stabël dhe pajisjet e tyre, në përfundim të periudhës së Koncesionit do t'i mbeten Autoritetit.

3.8 Data Efektive dhe Data e fillimit të afatit të Koncesionit:

3.8.1 Data Efektive e kësaj Kontrate do të jetë data në të cilën do të jenë përmbushur kushtet e pikave (i) dhe (ii):

(i) nënshkrimi i kësaj Kontratë nga të dyja Palët;

(ii) është përmbushur kushti i nenit 3.8.4

3.8.2 Me hyrjen në fuqi të Kontratës sipas nenit 3.8.1 dhe pasi Koncesionari të jetë pajisur, qoftë edhe për një qendër të vetme, me të gjithë lejet, licensat dhe/ose autorizimet e nevojshme që kërkohen nga legjislacioni shqiptar me qëllim zbatimin e këtij Projekti, fillojnë edhe efektet financiare sipas Kontratës për financimin e Koncesionarit (Aneksi 12).Vënia në funksion e secilës Qendër do të kryhet sipas përcaktimeve në DST dhe në Aneksin 5 "Nivelet e shërbimit dhe Plani i zbatimit".

3.8.3 Data e fillimit te afatit të Koncesionit do të jetë data në të cilën do të mundësohet dhënia e shërbimit objekt kontrate për të gjitha qendrat ku do të ofrohet shërbimi i hemodializës të rëna dakort mes palëve. Përpara datës së fillimit të afatit të Koncesionit nënkupton periudhën kohore nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në shtrirjen e shërbimit në të gjitha

qendrat e ofrimit të dializës pranë 5 spitaleve rajonale Elbasan, Vlorë, Korçë, Lezhë, Shkodër. Koncencionari do të fillojë dhënien e shërbimit sipas grafikut të parashikuar për çdo qendër, kohë pas kohe, dhe që do të kenë personelin e trajnuar sipas kritereve të përcaktuara në këtë kontratë. Për të hequr çdo dyshim, Data e fillimit të afatit të Koncesionit do të fillojë vetëm në momentin kur qendra e fundit shëndetësore do të fillojë dhënien e shërbimit, pavarësisht faktit që shërbimi mund të ketë filluar në qendrat e tjera përpara kësaj date.

Në çdo rast, data e fillimit të afatit të Koncesionit nuk mund të kalojë afatin dhjetëmujor të vitit të parë kalendarik 2016 dhe kjo kontratë do të konsiderohet se prodhon të gjitha efektet e saj financiare jo më vonë se data 1 Nëntor 2016, prej nga do të llogaritet dhe afati 10 vjeçar i koncesionit.

3.8.4 Në zbatim të Pikës 3, të VKM Nr. 308, datë 21.05.2014 "*"Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor"*;, Koncesionari dhe Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor do të nënshkruajnë kontratën përkatëse për financimin e shërbimit të kontrollit mjekësor bazë. Kontrata duhet të rregullojë e të përcaktojë, në mënyrë të hollësishme formën e dhënies së këtij shërbimi dhe mënyrën e pagesës së tij. Një kopje e kësaj Kontrate është parashikuar në Aneksin Nr. 12, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate.

3.9 Mosrespektimi i Datës Efektive.

3.9.1 Në rast se kushtet e përmendura në pikën 3.8 nuk përmbushen brenda periudhës së përcaktuar më sipër, atëherë palët detyrohen të hyjnë në negociata për zgjidhjen e problematikës që ka sjellë vonesa në Datën Efektive. Në rast se palët brenda një afati negocimi prej 30 ditësh nuk arrijnë të gjejnë një zgjidhje, ato mund të zgjidhin Kontratën në bazë të një njoftimi paraprak. Në vijim të marrjes së Njoftimit, Palët në këtë Kontratë nuk do të kenë të drejta apo detyrime të mëtejshme sipas kësaj Kontrate, përveç të drejtave dhe detyrimeve sipas Nenit 43 (Konfidencialiteti) dhe Nenit 65 (Ligji rregullues dhe Juridiksioni).

4. Plani i Projektit.

4.1 Koncesionari do të sigurojë Shërbimet në përputhje me Planin e Projektit. Koha do të jetë thelbësore në lidhje me zbatimin e Planit të Projektit.

4.2 Koncesionari do t'i sigurojë Autoritetit për miratim, një skemë te plotë dhe të detajuar të funksionimit të këtij Projekti brenda 20 ditëve nga Data e nënshkrimit të kësaj kontrate (planimetritë dhe projekt preventivat e zbatimit). Autoriteti do të paraqesë komentet e tij brenda 5 ditëve nga marrja. Në rast se Autoriteti kërkon të bëjë ndryshime apo përshtatje të tjera, atëherë Koncesionari do të ndryshojë, përshtatë dhe do të riparaqesë për miratim këtë projekt brenda një afati të arsyeshëm, por në çdo rast

jo më shumë se 5 ditë. Kur skema e Projektit të jetë miratuar nga Autoriteti atëherë Koncesionari konsiderohet se është i autorizuar të fillojë zbatimin e tij.

5. Testimi.

5.1 Kur Koncesionari konsideron se Projekti është gati për t'u testuar, ai do të paraqesë sistemin për testim dhe Palët do të ndjekin dispozitat e zbatueshme të Planit të Testimit.

5.2 Koncesionari do të përballojë të gjitha kostot në lidhje me Planin e Testimit. Duke marrë në konsideratë veçoritë e qendrave të ofrimit të shërbimit të hemodializës, Palët pranojnë faktin se zbatimi i këtij Projekti kërkon një koordinim tepër të madh (vonesa të konsiderueshme mund të ekzistojnë) dhe për këtë arsye mund të jetë e nevojshme që Koncesionari të paraqesë testime të pjesshme në intervale të caktuara kohe për ato pjesë të Projektit që janë përfunduar.

5.3 Nëse Koncesionari e kalon me sukses Testimin e kërkuar, qoftë të pjesshëm për secilën qendër, Autoriteti do të lëshojë një deklaratë pranimi. Koncesionari do të mbetet i vetmi përgjegjës për të siguruar që Propozimi i tij, siç është projektuar dhe zhvilluar, të jetë i përshtatshëm për kryerjen e Shërbimeve, për të siguruar që Shërbimet janë vënë në jetë në përputhje me këtë Kontratë dhe që Nivelet e Shërbimit janë arritur sipas Deklaratës së Pranimit. Me lëshimin e Deklaratës së Pranimit, Autoriteti lëshon menjëherë licencën përkatëse.

5.4 Nëse Koncesionarit nuk i jepet Deklarata e Pranimit në apo përpara Datës së Pikësynimit në lidhje me shërbimet e ofruara, pas një periudhë tolerimi prej 15 ditësh për secilin nga këto Pikësynime, do të zbatohen si të jetë e përshtatshme dispozitat e Neneve 7 (Vonesat në zbatim – Dispozita të Përgjithshme), 8 (Vonesat për Shkak të Pazotësisë së Koncesionarit), dhe 9 (Vonesa në Pikësynime për shkak të Autoritetit).

6. Vonesat në zbatim – Dispozita të Përgjithshme.

6.1 Nëse, në çdo kohë, Koncesionari ndërgjegjësohet se ai nuk do, apo se ka pak të ngjarë që, të arrijë cilindo nga Pikësynimet në Datën e Pikësynimit, ai do të njoftojë Autoritetin brenda një afati të arsyeshëm mbi:

6.1.1. Vonesën;

6.1.2. arsyet e mosarritjes së Pikësynimit;

6.1.3. pasojat e Vonesës; dhe

6.1.4. afatin kohor që do të përfshijë kjo Vonesë.

6.2 Koncesionari, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë pune pas njoftimit fillestar sipas Nenit 6.1, do t'i japë Autoritetit hollësi të plota për sa

është parashikuar në nenin 6.1 më lart. Nëse Koncesionari pretendon se Vonesa vjen për shkak të Autoritetit, ai njofton arsyen pse e paraqet atë pretendim me shkrim.

6.3 Në qoftë se Vonesa lidhet me veprimet apo mosveprimet e Autoritetit, Koncesionari do të vendosë në përdorim të gjithë burimet shtesë dhe do të marrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të shmangur apo ulur pasojat e Vonesës, dhe këto kosto shtesë të pësuara nga Koncesionari për faj të Autoritetit do të jenë në ngarkim të këtij të fundit. Koncesionari do të rimbursohet për kosto të tilla të nevojshme shtesë, të cilat paguhen nga Autoriteti, me kusht që të paraqitet dokumentacioni përkatës provues i këtyre kostove.

6.4 Çfarëdo konflikti në lidhje me apo si rrjedhojë e Vonesave do të zgjidhet përmes Procedurës për Zgjidhjen e Konflikteve. Gjatë kohës së zgjidhjes së Konfliktit të dy Palët do të vazhdojnë të punojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të zvogëluar pasojat e Vonesës.

6.5 Koncesionari do të paraqesë një projekt të Planit të Korrigjimit kur:

6.5.1 ai ndërgjegjësohet se nuk do të Arrijë Pikësynimin në Datën përkatëse të Pikësynimit; ose

6.5.2 ai ka dështuar në përpjekjen që të Arrijë një Pikësynim në Datën e këtij Pikësynimi, nëse ky dështim vjen si rrjedhojë e:

(i) mosarritjes për të ofruar cilindo apo të gjithë Shërbimet në lidhje me atë Pikësynim;

(ii) dështimit të Pikësynimit për të kompletuar apo arritur me sukses çfarëdo procesi testimi;

6.6 Projekt Plani i Korrigjimit do të përbëhet nga: i) përcaktimi i shkakut të Planit të Korrigjimit; ii) vlerësimi i nevojës për Planin e Korrigjimit; iii) përcaktimi i korrigjimit; iv) zbatimi i korrigjimit; dhe v) shqyrtimi i efektivitetit të korrigjimit.

6.7 Projekt Plani i Korrigjimit do t'i paraqitet Autoritetit për miratim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë pune (apo një periudhë kohore tjetër të tillë që Autoriteti mund të lejojë dhe të njoftojë Koncesionarin me shkrim) nga momenti i daljes së nevojës për korrigjim. Autoriteti jep përgjigjen në lidhje me Projekt Planin e Korigjimit brenda 10 ditëve pune.

6.8 Autoriteti nuk do të refuzojë miratimin e tij për një Projekt Plan Korrigjimi në mënyrë të paarsyeshme. Nëse Autoriteti nuk miraton Projekt Planin e Korrigjimit, ai do të informojë Koncesionarin brenda 10 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së Projekt Planit mbi arsyet e tij dhe Koncesionari do të marrë parasysh këto arsye në përgatitjen

e Projekt Planit të mëtejshëm të Korrigjimit, i cili do t'i njoftohet Autoritetit brenda 5 ditësh pune nga refuzimi i projektit të parë.

6.9 Koncesionari do të veprojë në përputhje me Planin e tij të Korrigjimit pas miratimit të tij nga Autoriteti ose me Planin e mëtejshëm të Korrigjimit pas njoftimit të Autoritetit.

6.10 Palët bien dakord që marrja nga Koncesionari dhe/ose Nën-kontraktuesit e tij të të gjitha licensave, autorizimeve dhe lejeve të nevojshme siç janë përcaktuar në Aneksin 3 (Propozimi i Koncesionarit) do të jetë e një natyre thelbësore për vënien në jetë të kësaj Kontrate. Në rast vonese për më shumë se 7 ditë në marrjen e liçensave dhe autorizimeve të tilla pas datës së paraqitjes nga Koncencionari të aplikimit të plotësuar saktësisht, Koncesionari nuk do të quhet se është në vonesë sipas kësaj Kontratë për ato vonesa që rrjedhin nga liçensa e vonuar dhe Koncesionari do të çlirohet nga çfarëdo dënimi apo pasoje të Vonesës që rrjedh nga licensa e vonuar dhe Periudha e Koncesionit, në rast se nuk ndikon në hyrjen në fuqi të Datës së fillimit të afatit të Konçesionit, do të zgjatet në përputhje me periudhën e vonesës, nëse Palët nuk arrijnë një zgjidhje tjetër.

7. Vonesat për Shkak të Pazotësisë së Koncesionarit

7.1 Nëse Sistemi nuk përmbush Kriteret e Testimit sipas nenit 5 dhe/ose secili nga Pikësynimet nuk arrihet si pasojë e Pazotësisë së Koncesionarit në përfundim të periudhës së përcaktuar më sipër në nenin 5 dhe 6,e vërtetuar kjo nga Autoriteti, atëherë Autoriteti do të lëshojë një Raport të Mospërputhjes ndaj Koncesionarit duke kategorizuar Çështjet e Testimit siç përshkruhen në Procedurat e Testimit apo duke përcaktuar me hollësi mospërputhjet e Sistemit atje ku janë kryer prova, duke përfshirë këtu çfarëdo arsye tjetër për Mosarritjen e Pikësynimit përkatës dhe pasojat vijuese mbi Pikësynimet e tjera. Autoriteti në këtë rast ka të drejtë të zbatojë parashikimet e Nenit7.2.

7.2 Autoriteti mundet që, në vlerësimin e tij dhe pasi të ketë provuar shkaqet (pa hequr dorë nga asnjë e drejtë në lidhje me mundësitë e tjera) të zgjedhë që:

7.2.1 nëse problemi i provës së Testimit nuk është një çështje që ndikon drejtpërdrejt në ofrimin e Shërbimeve, të lëshojë një Deklaratë Pranimi duke e kushtëzuar vlefshmërinë e saj me rregullimin e Problemit të Testimit, ose të mospërputhjeve të Sistemit atje ku nuk janë kryer prova, në përputhje me Planin e Korrigjimit të dakordësuar; ose

7.2.2 nëse problemi i provës së Testimit është një çështje që ndikon drejtpërdrejt në ofrimin e Shërbimeve, të refuzojë të lëshojë një Deklaratë Pranimi të kushtëzuar siç përcaktohet me hollësi në Nenin 7.2.1 dhe t'i referohet çështjes së Procesit të Përshkallëzimit dhe nëse çështja nuk mund të zgjidhet, të ushtrojë çdo të drejtë që ai mund të ketë sipas Nenit 50 (Zgjidhja);

7.2.3 të kërkojë kryerjen e Pagesave të Vonesës, të cilat do të jenë të pagueshme nga ana e Koncesionarit sipas kërkesës së Autoritetit, atje ku Aneksi 7 (Çështje Financiare) identifikon se Pagesat e Vonesës janë të pagueshme në lidhje me Pikësynimin përkatës. Pagesat e Vonesës do të mblidhen mbi një bazë javore për çdo javë të plotë, që nga data e Pikësynimit përkatës dhe do të vazhdojnë të mblidhen deri në datën kur Pikësynimi të Arrihet në përputhje me Planin e Korrigjimit. Për qëllimet e vlerësimit nëse Koncesionari ka dështuar apo jo në Arritjen e një Pikësynimi, afati për një vlerësim të tillë do të përfundojë në orën 12.00 PM të datës së Pikësynimit.

7.3 Nëse Autoriteti lëshon një Deklaratë Pranimi të kushtëzuar siç përcaktohet me hollësi në Nenin 7.2.1, ai ka të drejtë të rishikojë datën e Pikësynimit të papërmbushur dhe çdo datë Pikësynimi vijues duke informuar Koncesionarin brenda një kohe të mjaftueshme për datën e re të arsyeshme të Pikësynimit.

7.4 Çdo Plan Korrigjimi do të miratohet prej Palëve përpara lëshimit të një Deklarate Pranimi të kushtëzuar përveçse kur Autoriteti është i gatshëm të pranojë ndryshe. Në këtë rast, Koncesionari do të paraqesë një Projekt Plan Korrigjimi për miratim nga Autoriteti brenda 10 ditëve pune që nga marrja e Raportit të Mospërputhjes. Autoriteti nuk do të refuzojë miratimin e tij për një Projekt Plan Korrigjimi në mënyrë të paarsyeshme. Nëse Autoriteti nuk miraton Projekt Planin e Korrigjimit, ai do të informojë Koncesionarin brenda 10 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së Projekt Planit mbi arsyet e tij dhe Koncesionari do të marrë parasysh këto arsye në përgatitjen e Projekt Planit të mëtejshëm të Korrigjimit, i cili do t'i njoftohet Autoritetit brenda 5 ditëve pune nga refuzimi i projektit të parë.

7.5 Koncesionari do të veprojë në përputhje me Planin e tij të Korrigjimit pas miratimit të tij nga Autoriteti ose me Planin e mëtejshëm të Korrigjimit pas njoftimit të Autoritetit.

7.6 Të gjitha Pagesat e Vonesës të pagueshme nga Koncesionari për Autoritetin sipas pikës 7.2.3 do të paguhen si penalitet për vonesën.

8. Vonesat në arritjen e Pikësynimeve për Shkak të Autoritetit.

8.1 Ndryshe nga sa parashikohet në Nenin 7, nëse Koncesionari nuk ka arritur Pikësynimin në Datën përkatëse për shkak të veprimeve apo mosvprimeve të Autoritetit, atëherë, pasi Koncesionari të ketë dhënë njoftimin paraprak me shkrim për Autoritetin mbi Shkakun e Autoritetit, do të përfitojë nga të drejtat dhe lehtësimi i përcaktuar në këtë Nen.

8.2 Nëse për shkak të Autoritetit, konstatohet një mosarritje për të Përmbushur një Pikësynim, atëherë Koncesionari:

8.2.1 sipas Nenit 8.3, do t'i lejohet një zgjatje e afatit e barabartë me Vonesën e shkaktuar nga Shkaku i Autoritetit;

8.2.2 nuk do të kryejë asnjë prej Pagesave të Vonesës në lidhje me Pikësynimin përkatës në masën që vërtetohet se Vonesa vjen drejtpërdrejt nga Shkaku i Autoritetit.

8.2.3 do të ketë të drejtë të ngrejë pretendime për shpenzimet e kryera nga Koncesionari për shkak të Pazotësisë së Autoritetit, si dhe do të rimbursohet për kosto të tilla të arsyeshme e të nevojshme shtesë, kundrejt paraqitjes së dokumentacionit përkatës provues të këtyre kostove shtesë.

8.3 Autoriteti:

8.3.1 do të miratojë kohëzgjatjen e Vonesës, natyrën e Pazotësisë të Autoritetit dhe pasojën e Vonesës;

8.3.2 do të këshillohet me Përfaqësuesin e Koncesionarit për të përcaktuar pasojën e Vonesës dhe për të minimizuar pasojat negative atje ku kjo është e mundur;

8.3.3 caktojë një Datë të Rishikuar të Pikësynimit; dhe

8.3.4 nëse Shkaku i Autoritetit vijon ose Data e Rishikuar e Pikësynimit ka qenë e pamjaftueshme për Koncesionarin, të bëjë çdo rishikim vijues ndaj Pikësynimeve të ardhshme në Planin e Zbatimit.

8.4 Nëse është e mundur, Koncesionari do të ndërmarrë dhe vazhdojë (dhe do të sigurojë që secili Nën-kontraktor të ndërmarrë e të vazhdojë) të gjithë hapat e arsyeshëm për të zhdukur apo ulur çfarëdo humbjesh dhe/ose shpenzimesh që ai ka si rrjedhojë e një veprimi apo mosveprimi të Autoritetit.

8.5 Në çdo Rast, nëse vërtetohet se Koncesionari nuk do të arrijë të Përmbushë një Pikësynim si pasojë e mospërmbushjes nga ana e Autoritetit sipas nenit 8, do të vlerësohet si përgjegjësi e vetme e Autoritetit dhe ky i fundit është i detyruar për të shlyer çdo dëm të mundshëm kontraktor që vjen si pasojë e paaftësisë, e ndonjë abuzimi të mundshëm apo veprimi apo mosveprimi tjetër të Autoritetit. Dispozitat e neneve 8.1 deri 8.5 nuk do të interpretohen si lehtësim i detyrimeve të Autoritetit ndaj Koncesionarit apo shmangie nga çdo dëm të mundshëm i kërkueshëm sipas kësaj kontrate. Koncencionari do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ofruar në mënyrë të pandërprerë dhe pa vonesë Shërbimet, duke patur parasysh rëndësinë publike të tyre, me përjashtim të rastit kur mospërmbushja/vonesa nga Autoriteti ndikon drejtpërdrejt në ofrim në kohë dhe pa vonesë të Shërbimeve.

9. Shërbimet

9.1 Koncesionari do të sigurojë Shërbimet dhe do të sigurojë që Shërbimet:

9.1.1 të përputhen në të gjitha aspektet me Kërkesat e Autoritetit siç përcaktohet në Aneksin 2 (Kërkesat e Autoritetit)dhe/ose siç ato mund të shtohen, zgjerohen, ndryshohen apo zëvendësohen në Aneksin 4 ose në përputhje me Procedurën e Ndryshimit të Kontratës siç përcaktohet në Aneksin 11;

9.1.2 të jepen në përputhje me Propozimin e Koncesionarit të parashikuar në Aneksin 3 dhe siç ato mund të shtohen, zgjerohen, ndryshohen apo zëvendësohen në Aneksin 4 ose në përputhje me Proçedurën e Ndryshimit siç përcaktohet në Aneksin 11;

9.1.3 të përputhen në çdo kohë me Anekset e parashikuara në këtë Kontratë përfshirë këtu Planin e Zbatimit.

9.2 Pa paragjykim ndaj 9.1, Koncesionari do të ofrojë këto Shërbimet e tij sipas Nivelit të Shërbimit të parashikuar në Nenin 10.

9.3 Koncesionari do të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate në përputhje me:

9.3.1 Praktikat e Industrisë së Përparuar;

9.3.2 Procedurat dhe praktikat e vendosura nga ana e vetë Koncesionarit;

9.3.3 Politikën e Sigurisë;

9.3.4 Planet e Cilësisë;

9.3.5 Të gjitha udhëzimet e arsyeshme të dhëna ndaj Koncesionarit nga Përfaqësuesi i Projektit për Autoritetin gjatë periudhës koncesionare në masën që këto udhëzime lidhen apo përkojnë me Shërbimet me kusht që këto udhëzime të jenë në përputhje me këtë Kontratë dhe të pranohen nga Koncesionari; dhe

9.3.6 Nivelin e aftësive profesionale, kujdesit, planifikimit, mbikqyrjes, kontrollit dhe gjykimit të cilat mund të priten nga një shoqëri profesioniste me përvojë në dhënien e shërbimeve të tipit dhe kompleksitetit të kërkuar nga Autoriteti sipas kësaj Kontrate.

9.4 Koncesionari do të njoftojë mbi çdo konflikt ndërmjet cilësdo nga kërkesat e Nenit 9.1 dhe kërkesat e Nenit 9.2 në vëmendjen e Autoritetit dhe do të veprojë në përputhje me vendimin e Palëve për zgjidhjen e atij konflikti.

9.5 Koncesionari do të sigurojë që Shërbimet dhe Sistemi i Koncesionarit të integrohen me Sistemin e Autoritetit në masën që është e nevojshme për të siguruar Shërbimet.

10. Nivelet e Shërbimit.

10.1 Koncesionari do të sigurojë që Shërbimet e ofruara të arrijnë apo tejkalojnë Nivelet e Shërbimit në datat e Pikësynimit. Dispozitat e mbetura të Nenit 10 zbatohen në funksion dhe të dispozitave të Nenit 11 (Pasoja e Mospërmbushjes nga ana e Autoritetit në Fazën Operacionale).

10.2 Nëse ka një Dështim të Shërbimit apo nëse Koncesionari beson se do të ketë një Dështim të Shërbimit, Koncesionari:

10.2.1 do të njoftojë Autoritetin menjëherë për Dështimin e Shërbimit apo Dështimin e mundshëm të Shërbimit;

10.2.2 do t'i sigurojë Autoritetit një Plan Korrigjimi të veprimit që ai do të ndërmarrë për të ndrequr Dështimin e Shërbimit që të mos ndodhë apo ndodhë përsëri, brenda 10 ditëve të punës nga data që Koncesionari njofton Autoritetin sipas Nenit 10.2.1;

10.2.3 do të vërë në përdorim të gjitha burimet shtesë dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet rregulluese që janë të nevojshme për të ndrequr apo për të parandaluar Dështimin e Shërbimit që të ndodhë apo që të ndodhë përsëri; dhe

10.2.4 do të kryejë një Plan Korrigjimi të dakordësuar sipas Nenit 10.2.2, në përputhje me termat e tij.

11. Pasoja e Mospërmbushjes nga ana e Autoritetit në Fazën Operacionale

11.1 Nëse Konçesionari do t'i ofronte Shërbimet në pajtim me Nivelet e Shërbimit dhe/ose këtë Kontratë, por ka dështuar të bëjë kështu për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të Autoritetit, Konçesionari përfiton të drejtat dhe asistencën të parashikuara në këtë nen, të cilat zbatohen në mënyrë të pavarur prej të drejtave të tjera të parashikuara nga kjo Kontratë. Mospërmbushja nga ana e Autoritetit konsiderohet e kryer edhe sikur të jetë e lidhur me vetëm një nga qendrat shëndetësore. Koncesionari:

11.1.1 (në matjen e kryerjes së çdo Shërbimi) do të trajtohet sikur Shërbimi ka arritur Nivelin e Shërbimit të përshtatshëm; dhe,

11.1.2 do të ketë të drejta ndaj Çmimit (pagesës) për Seancë të plotë, duke u trajtuar sikur shërbimet të jenë kryer konform kësaj Kontrate duke filluar që nga data e Kohës së Vënies në Shfrytëzim në rastin kur Shërbimet nuk kanë filluar të jepen ose, në rast se Shërbimet janë dhënë gjatë një periudhe kohe, qoftë pjesërisht për njërën nga qendrat, që nga data e fillimit të mospërmbushjes nga ana e Autoritetit deri në momentin kur Koncesionari të njoftohet dhe të jetë vënë në kushtet për të ofruar Shërbimet për të gjitha qendrat konform kësaj Kontrate; dhe,

11.1.3 do të ketë të drejtë të ngrejë pretendime për shpenzime të nevojshme të kryera prej tij për shkak të Pazotësisë/Fajit/Mospërmbushjes së Autoritetit. Koncesionari do të rimbursohet për kosto të tilla të arsyeshme e të nevojshme shtesë si dhe do të dëmshpërblehet për dëmin që mund të ketë pësuar nga sjella e Autoritetit me kusht që: i) të jetë vërtetuar detyrimi i Autoritetit për të vepruar ose mosvepruar; dhe ii) të sigurohet dokumentacion provues lidhur me kostot e kryera dhe dëmin e pësuar nga Koncesionari.

11.2 Koncesionari do të pajisë Autoritetin me detajet e Mospërmbushjes së Autoritetit në përputhje me Nenin 48.3.6, në mënyrë që të përfitojë të drejtat dhe asistencat sipas pikës 11.1.

11.3 Çdo konflikt që lind në rastin e dështimit të Koncesionarit për të ofruar Shërbimet në pajtim me Nivelet e Shërbimit dhe/ose këtë Kontratë për shkak të Mospërmbushjes së Autoritetit do të zgjidhet përmes Proçedurës së Zgjidhjeve të Konflikteve. Në pritje të zgjidhjes së konflikteve të dyja palët do të vazhdojnë të zbatojnë Kontratën dhe të zbutin efektet e këtij dështimi.

12. Standardet.

Koncesionari do të pajtohet me Standardet e përmendura apo të referuara në Anekset 2 dhe 3 dhe/ose 4, në rast se zbatohet, në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate në përmbushjen e detyrimeve të tij.

13. Garantimi i Cilësisë.

13.1 Koncesionari do të zhvillojë përpara Datës së fillimit të afatit të Koncesionit, Plane të Cilësisë që:

13.1.1 Të sigurojnë që të gjithë aspektet e Shërbimeve janë subjekt i sistemeve të menaxhimit të cilësisë; dhe

13.1.2 Janë në përputhje me standardet e cilësisë sipas akreditimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit pranë Ministrisë Kompetente (çështje të sigurisë së IT, menaxhimit të të dhënave dhe konfidencialitetit) ose çdo standard ekuivalent sipas akreditimit të kryer nga ndonjë person juridik privat ose i huaj i autorizuar për kryerjen e akreditimit.

13.1.3 për më tepër, që të sigurojë të gjitha certifikatat e akreditimit (nëse ka dhe nëse mund të merret ndonjë certifikatë tjetër të nevojshme për këtë aktivitet).

13.1.4 përjashtimisht, Koncesionari nuk do të konsiderohet në shkelje të tyre në rast se procedurat e akreditimit dhe/ose certifikimit janë të tilla që mund të sigurohen përtej Datës së fillimit të afatit të Koncesionit.

13.2 Koncesionari garanton që Shërbimet të zhvillohen edhe në pajtim me Planet e Cilësisë.

13.3 Kontrolli i Autoritetit për Shërbimet.

13.3.1 Autoriteti mund të monitorojë kryerjen e Shërbimeve nga Koncesionari në përputhje me procedurat e përshkruara në Aneksin 2 (Kërkesat e Autoritetit).

13.3.2 Autoriteti do t'i japë Koncesionarit një njoftim të arsyetuar paraprak me shkrim në lidhje me qëllimin e tij për të rritur nivelin e vëzhgimit.

13.3.3 Në rast të ushtrimit të kontrollit për Sistemin, frekuenca e kontrolleve të ushtruara nga Autoriteti nuk mund të jetë më shumë se 1 (një) kontroll çdo 1 (një) vit. Në çdo rast Autoriteti duhet të njoftojë më shkrim Koncesionarin për datën dhe vendin e Kontrollit si dhe të japë një përshkrim të detajuar të kontrolleve që do të ushtrojë. Njoftimi për kontroll do të bëhet të paktën 15 ditë përpara datës se përcaktuar për kontroll.

13.3.4 Koncesionari do të bashkëpunojë dhe do të sigurojë që të gjithë nën-kontraktuesit e tij të bashkëpunojnë me Autoritetin për zhvillimin e kontrollit të referuar në Nenin 13.3.

14. Përmirësimi i Shërbimeve.

14.1 Koncesionari do të ketë një detyrim të vazhdueshëm përgjatë gjithë kohës për të identifikuar, në rast se është e mundur, përmirësime të reja ose potenciale të Shërbimeve në pajtim me këtë Nen dhe Aneksin 2 (Kërkesat e Autoritetit), Aneksin 3 ose Aneksin 4 në rast se është i zbatueshëm. Si pjesë e këtij detyrimi Koncesionari do të identifikojë dhe raportojë tek Bordi i Menaxhimit të Projektit të përcaktuar në Aneksin 8 çdo 6 muaj për:

14.1.1 Nevojën e teknologjive përkatëse te reja dhe të përparuara, të cilat mund të përmirësojnë Sistemin dhe/ose Shërbimet, dhe të identifikojë këto teknologji të përparuara potencialisht të mundshme për Koncesionarin dhe Autoritetin; dhe/ose

14.1.2 Përmirësime të reja ose të mundshme të Shërbimeve duke përfshirë cilësinë, përgjegjshmërinë, procedurat, si mekanizmat e performancës dhe shërbimet mbështetëse në lidhje me Shërbimet; dhe/ose

14.1.3 Ndryshimet në proceset e punës gjatë ofrimit të Shërbimit si dhe në mënyrat e punës që mund të bëjnë të mundur që Shërbimet të garantohen me cilësi më të lartë ose me përfitim më të madh për përfituesit e shërbimit.

14.2 Koncesionari do të sigurojë që informacioni që do t'i jepet Autoritetit të jetë i mjaftueshëm për Autoritetin që të përcaktojë nëse ndonjë përmirësim duhet të zbatohet. Koncesionari do të japë çdo informacion të mëtejshëm që Autoriteti i kërkon.

14.3 Nëse Autoriteti pranon të përfshijë ndonjë përmirësim të identifikuar nga Koncesionari, Autoriteti do t'i dërgojë Koncesionarit një Kërkesë Ndryshimi dhe palët do:

14.3.1 Zhvillojnë një plan për zbatimin e përmirësimit brenda një afati 20 ditë pune pas Kërkesës së Ndryshimit të Autoritetit, për aprovimin e Autoritetit; plani i zbatimit duhet të miratohet nga ana e autoritetit brenda një afati të arsyeshëm.

14.3.2 Zbatojnë përmirësimin në përputhje me parashikimet e një plani të zbatimit, i miratuar nga Autoriteti; dhe

14.3.3 T'i nënshtrojnë përmirësimet për t'u testuar, në pajtim me parashikimet e Aneksit 6 (Testimi).

14.4 Nëse përmirësimi i Shërbimit ka lidhje me ndryshime rrënjësore për Koncesionarin atëherë kostot shtesë do të trajtohen ne përputhje me dispozitat e Nenit 16.2 më poshtë.

15. Sistemi dhe Siguria.

15.1 Me përjashtim të rastit kur palët do të bien dakord me shkrim ndryshe, Sistemi do të përdoret nga Koncesionari vetëm për qëllimet e ofrimit të Shërbimeve për Autoritetin dhe nuk do të përdoret për qëllimet e veta të Koncesionarit ose për ofrimin e shërbimeve të tjera palëve të treta.

15.2 Duke patur parasysh që Autoriteti do të ofrojë dhe sigurojë të njëjtin nivel sigurie dhe të praktikojë të njëjtën shkallë përkushtimi, kujdesi dhe kontrolli në lidhje me materialet, mjetet dhe pajisjet mjekësore dhe jomjekësore të Koncesionarit të lokalizuara në qendrat e ofrimit të shërbimit të dializës, të ngjashëm me përkujdesin që ka për pronat dhe sendet e tij në këto Qendra, atëherë të gjitha pronat dhe sendet e Koncesionarit të lokalizuara në këto Qendra, do të qëndrojnë nën riskun, përgjegjësinë dhe kostot e Autoritetit, sipas Neneve 37 dhe 38. Autoriteti do të përgjigjet dhe do të zhdëmtojë menjëherë Koncencionarin për çdo humbje apo dëmtim të materialeve, pajisjeve dhe mjeteve të furnizuara nga Koncesionari për qendrat e ofrimit të shërbimit të dializës.

Me qëllim që të identifikohen mjetet, pajisjet dhe materialet e furnizuara nga Koncesionari, në momentin e fillimit të dhënies së shërbimit, palët do të hartojnë një procesverbal dorëzimi. Procesverbali do të nënshkruhet nga ana e përfaqësuesve të Koncesionarit, dhe përfaqësuesit të spitalit rajonal pranë të cilit është ngritur qendra ku

ofrohet shërbimi i dializës. Procesverbali do të hartohet në katër kopje, një për Autoritetin, një për Koncesionarin, një për përfaqësuesin e spitalit rajonal dhe kopja e katërt për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

16. Çështje financiare.

16.1 Kostot dhe shpenzimet.

16.1.1 Palët bien dakord që çfarëdo kostoje dhe shpenzimi në lidhje me vënien në zbatim të Koncesionit do të jetë në përputhje me dispozitat e Aneksit 7(Çështje financiare) të kësaj Kontrate.

16.1.2 Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë apo tjetërkund, secila Palë do të paguajë kostot e saj, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për komunikimin, negocimin, përgatitjen dhe realizimin e kësaj Kontrate.

16.2 Kostot dhe shpenzimet e rishikimit.

16.2.1 Rishikimi i kostove dhe shpenzimeve të Koncesionit bëhet me pëlqimin e ndërsjelltë me shkrim të Palëve në përputhje me Procedurën e Ndryshimit të Kontratës. Një rishikim i tillë i kostove dhe shpenzimeve do të zbatohet gjithashtu në rastin e ndryshimeve të kërkuara nga Autoriteti në Sistem apo në Shërbimet e përshkruara në këtë Kontratë dhe të pranuara nga Koncesionari. Asnjë ndryshim i Sistemit apo Shërbimeve nuk do të ndërmerret nga Koncesionari pa një Marrëveshje me shkrim ndërmjet Autoritetit dhe Koncesionarit mbi këto kosto shtesë.

16.2.2 Palët do të takohen dhe do të diskutojnë mbi rishikimin e kostove dhe shpenzimeve brenda 15 ditëve nga marrja e një njoftimi me shkrim nga pala tjetër. Koncesionari nuk është i detyruar që të mbajë përsipër kostot shtesë në lidhje me ndryshimet e nevojshme për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të detyrueshme të hyra në fuqi pas Datës së Nënshkrimit përveçse kur kosto të tilla janë pranuar në përputhje me Procedurën e Ndryshimit të Kontratës. Në mungesë të një marrëveshjeje me shkrim mes palëve, kosto të tilla mbahen përsipër prej Autoritetit.

16.3 Çmimi për Shërbimet e Ofruara.

16.3.1 Çmimi për Shërbimet e Ofruara do të jetë çmimi i paraqitur nga Koncesionari dhe i pranuar nga Autoriteti, siç përcaktohet në Aneksin 7 (Çështje Financiare). Çmimi për Shërbimet e ofruara do të jetë çmim neto (duke përjashtuar TVSH). Fatura e lëshuar nga ana e Koncencionarit do të jetë faturë tatimore me TVSH të llogaritur mbi çmimin neto.

16.3.2 Duke marrë në konsideratë kohën e gjatë të Periudhës së Koncesionit, palët bien dakord që Çmimi mund të jetë objekt rishikimi sipas vlerave të

përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Pavarësisht sa më sipër, çmimi më i ulët i zbatueshëm gjatë gjithë periudhës së Koncesionit nuk do të jetë më i ulët se çmimi për njësi i ofertuar nga Koncesionari dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktor (Aneksi 3).

16.3.3 Rishikimi i Çmimit do të bëhet me kusht që Koncesionari të ketë njoftuar Autoritetin për rishikimin e Çmimit dhe masën e këtij rishikimi, të paktën 30 ditë përpara aplikimit të Çmimit të ri, ose anasjelltas.

16.3.4 Në vlerën e Çmimit për Shërbimet e Ofruara është përjashtuar çdo kosto për çdo transfertë financiare për në llogarinë bankare të Koncesionarit të kryera përmes institucioneve bankare. Kosto të tilla janë përgjegjësi e Autoritetit.

16.3.5 Çmimi për Shërbimet e Ofruara do të paguhet me bazë mujore i shpërndarë proporcionalisht përgjatë një viti të plotë financiar sipas modaliteteve të përcaktuara në marrëveshjen e financimit të lidhur me Fondin, Aneksi 12 i kësaj Kontrate.

16.3.6 Autoriteti garanton Koncesionarin të aplikojë dhe kërkojë, në bazë mujore, vlerën totale të detyrueshme sipas çmimit për njësi, seanca të parashikuara sipas protokollit dhe numrit të pacienteve të projektuar ne DST. Rastet që tejkalojnë projeksionin e DST do të faturohen, në baza mujore, sipas numrit të seancave të kryera dhe çmimit për njësi të ofruar nga Koncesionari.

16.4 Financimi i Koncesionit.

16.4.1 Konçesionari do të bëjë të gjitha përpjekjet dhe do të sigurojë një financim të përshtatshëm (qoftë përmes financimit me kredi, qoftë përmes kapitaleve të tij, qoftë përmes një kombinimi të tyre) të Koncesionit dhe përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

16.4.2 Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim që të japë kontribute të cilitdo lloj (financiare apo të tjera) në lidhje me Koncesionin.

17. Taksat

17.1 Në zbatim të këtij projekti, Koncesionari deklaron dhe Autoriteti pranon se përllogaritja e Çmimit të Shërbimit është kryer mbi bazën e tarifave aktuale të taksave dhe tatimeve të çdo lloji (përfshirë ato doganore) në ditën në të cilën Koncesionari ka paraqitur Ofertën e tij. Çdo ndryshim në të ardhmen në lidhje me ndonjë taksë apo tatim do të jetë menjëherë subjekt i rishikimit të Çmimit deri në atë masë sa është ndikuar Koncesionari. Procedura e ndjekur në këtë rast është e njëjtë me atë të nenit 16.3.3.

18. Përfaqësuesit.

18.1 Koncesionari do të caktojë personat e emëruar si të tillë në Aneksin 8 (Organigrama e Koncesionarit) si Përfaqësues i Koncesionarit. Përfaqësuesi i Koncesionarit do të ketë autoritetin të veprojë në emër të Koncesionarit në lidhje me çështjet e caktuara ose në lidhje me këtë Kontratë.

18.2 Autoriteti do të emërojë Përfaqësuesin e Autoritetit. Përfaqësuesi i Autoritetit do të ketë autoritetin për të vepruar në emër të Autoritetit në çështjet e përcaktuara në, apo në lidhje me, këtë Kontratë në përputhje me dispozitat mbi rregullimin siç mund të ripërcaktohen apo të bihen më tej dakord nga Palët.

18.3 Përfaqësuesi brenda organizatës së Koncesionarit do të ketë përvojën e mjaftueshme dhe do t'i jepet autoritet i mjaftueshëm për të siguruar bashkëpunim të plotë në lidhje me veprimtarinë dhe menaxhimin e kësaj Kontrate.

18.4 Për aq kohë sa një palë nuk i ka njoftuar palës tjetër përfundimin e autorizimit ose kufizimin e të drejtave të përfaqësuesit të saj, ky i fundit konsiderohet të ketë autoritetin e mjaftueshëm për të vepruar dhe veprimet e kryera prej tij pranohen prej palës tjetër pa asnjë rezervë.

19. Rregullimi.

Palët bien dakord që të menaxhojnë këtë Kontratë përmes dispozitave mbi rregullimin të përcaktuara në Anekset 2, 3 e 4 siç mund të përcaktohen apo pranohen më tej nga Palët.

20. Nënkontraktimi.

20.1 Koncesionari ka të drejtë të nënkontraktojë secilin nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate duke e njoftuar paraprakisht Autoritetin duke mare paraprakisht miratimin e autoritetit. Për mënjanimin e çdo dyshimi, furnizuesit e pajisjeve, dërgesave, programeve kompjuterike, njësive kompjuterike, riparuesit e këtyre pajisjeve nuk do të konsiderohen nënkontraktorë sipas kësaj Kontrate.

20.2 Sipas Nenit 20.1, Koncesionari do të pajisë Autoritetin me informacionin e mëposhtëm për Nënkontraktuesin e propozuar:

20.2.1 Emrin e tij dhe adresën;

20.2.2 Qëllimet për të cilat nënkontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë qëllimin e çdo shërbimi që do të ofrohet nga nënkontraktuesi i propozuar;

20.2.3 Dokumentacion mbështetës që vërteton kapacitetin e tij teknik për përmbushjen e qëllimeve të nënkontraktimit;

20.2.3 Çdo informacion të mëtejshëm të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti.

20.3 Koncesionari vazhdon të mbetet përgjegjës kundrejt Autoritetit për performancën e nënkontraktorëve gjatë gjithë periudhës koncesionare.

21. Rishikimi i Shërbimit.

Në çdo kohë, secila Palë ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër që të hyjë në bisedime në lidhje me rishikimin e Shërbimeve dhe gjithë ndryshimet e dakordësuara do të miratohen përmes Procedurës së Ndryshimit të Kontratës sipas Aneksit 11.

22. Kontrollet.

22.1 Autoriteti mund të ushtrojë kontrolle sipas modaliteteve të përcaktuara në nenet 13.3.2 dhe 13.3.3 për të gjithë qëllimet e konsideruara prej tij si të nevojshme gjatë periudhës koncesionare, duke përfshirë por pa u kufizuar sa më poshtë:

22.1.1 vlerësim të integritetit, konfidencialitetit dhe sigurisë të të Dhënave të Koncesionarit;

22.1.2 vlerësim i zbatimit të duhur të legjislacionit për Shërbimet prej Koncesionarit;

22.1.3 vlerësim i zbatimit të duhur të detyrimeve të Koncesionarit sipas Nenit 9.1 dhe 9.3 (Shërbimet) dhe 13 (Garantimi i Cilësisë);

22.1.4 vlerësim të çdo materiali të kërkuar dhe të krijuar në mënyrë të arsyeshme gjatë skicimit dhe zhvillimit të Sistemit dhe rrethanave paraoperacionale duke përfshirë informacionin lidhur me përbërësit dhe skicimin e sistemit, përcaktimet e hollësishme të testit, raportet e testimit të rezultateve dhe planet e zbatimit;

22.1.5 inspektim të Sistemit (ose çdo pjesë të tij).

22.2 Autoriteti garanton që kryerja e secilit kontroll nuk e ndërpret në mënyrë të paarsyeshme Koncesionarin ose të shkaktojë vonesa në kryerjen e Shërbimeve.

22.3 Koncesionari do t'i sigurojë menjëherë Autoritetit (dhe/ose agjentëve të tij ose përfaqësuesve), të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, të gjithë bashkëpunimin e arsyeshëm dhe ndihmën lidhur me çdo kontroll, duke përfshirë:

22.3.1 të gjithë informacionin e kërkuar nga Autoriteti brenda qëllimit të kontrollit;

22.3.2 mundësi hyrjeje në çdo Zonë të kontrolluar nga Koncesionari;

22.3.3 mundësi hyrjeje në Sistem;

22.4 Koncesionari do të zbatojë të gjitha masat e monitorimit dhe procedurat e nevojshme për të matur dhe raportuar mbi performancën e tij për Niveline Shërbimit.

22.5 Autoriteti duhet të kryejë një njoftim paraprak minimal prej 15 Ditë Pune në lidhje me qëllimin e tij për të kryer një kontroll sipas këtij neni.

22.6 Palët bien dakord që secila prej tyre do të marrë përsipër kostot përkatëse dhe shpenzimet e shkaktuara lidhur me përputhshmërinë me detyrimet e tyre sipas këtij Neni.

22.7 Në qoftë se një kontroll identifikon që Koncesionari ka dështuar për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, Palët bien dakord dhe zbatojnë një Plan Korrigjimi siç është përcaktuar në këtë Kontratë dhe në rast dështimi mund të vijojnë me procedurat e zgjidhjes së Kontratës.

23. Regjistra dhe Raporte.

Palët do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Aneksit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe 3 (Propozimi i Koncesionarit) dhe, nëse zbatohet Aneksi 4 (Ndryshimet), lidhur me mbajtjen e të dhënave dhe hartimin e raporteve. Koncesionari do t'i sigurojë Autoritetit të dhëna dhe raporte mbi një bazë të rregullt në intervale 6 mujore në mënyrë dhe formë të atillë siç mund të përcaktohet me hollësi nga Autoriteti.

24. Procedura e Ndryshimit të Kontratës.

24.1 Çdo kërkesë për Ndryshim do t'i nënshtrohet Procedurës së Ndryshimit të Kontratës. Pa rënë ndesh me Procedurën e Ndryshimit të Kontratës (Aneksi 11), Palët dakordësojnë se Kërkesa për Ndryshim, ndërmjet të tjerave, duhet të përmbajë sa më poshtë:

24.1.1 arsyen e ndryshimit;

24.1.2 përfitimin/dobinë e ndryshimit;

24.1.3 humbjen nga mosaprovimi i ndryshimit;

24.1.4 afatin kohor për hyrjen në fuqi të ndryshimit.

Shqyrtimi i kërkesës për ndryshim do të bëhet brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor.

24.2 Nëse pas Datës së Nënshkrimit hyn në fuqi, nxirret apo shtohet çfarëdo ligji, akti që ka fuqinë e ligjit në Republikën e Shqipërisë, ose VKM i cili ndikon termat/afatet,

përfshirë këtu mënyrën dhe/ose datën e dorëzimit të Shërbimeve dhe/ose çmimin e këtyre shërbimeve atëherë afatet, kushtet dhe/ose çmimi i Shërbimeve në përputhje me këtë Kontratë do të përshtaten dhe/ose rregullohen sipas Procedurës për Ndryshimin deri në masën që Koncesionari është prekur.

25. Personeli.

25.1 Koncesionari do të sigurojë që ai ka personel të mjaftueshëm në mënyrë që të plotësojë kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë.

25.2 Koncesionari do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar vazhdimësinë e personelit dhe do të sigurojë që ofrimi dhe/ose menaxhimi i shërbimeve është së paku po aq i lartë sa edhe standardet e shërbimit për një Koncesionar që është duke operuar në përputhje me Protokollin e Hemodializës për shërbime, zona dhe rrethana të njëjta.

25.3 Koncesionari njeh dhe pranon që personeli është themelor për ofrimin e shërbimeve të duhura ndaj Autoritetit. Koncesionari do të sigurojë që çdo zëvendësim do të jetë i kualifikuar dhe me përvojën e përshtatshme dhe tërësisht kompetent për të zbatuar detyrat e caktuara të Personelit Kryesor të cilin ai ose ajo ka zëvendësuar.

25.4 Koncesionari do të sigurojë trajnime personeli në mënyrë që të dokumentojë proceset administrative dhe të ndihmojë në përdorimin, mirëmbajtjen dhe përvetësimin e njohurive të reja në lidhje me përdorimin, zbatimin dhe operimin e Sistemit. Kushtet e përgjithshme dhe specifike të trajnimit janë të rregulluara nga Aneksin 3 (Propozimi i Koncesionarit) i kësaj Kontrate.

26. Detyrimet e marra përsipër nga Koncesionari.

26.1 Koncesionari bie dakord si vijon:

26.1.1 Shoqëria Koncesionare e krijuar për qëllimin e këtij koncesioni do të ketë të njëjtën strukturë të ortakëve, siç është përcaktuar në Kontratën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik. Shoqëria koncencionare krijohet në përputhje me ligjin për koncesionet si dhe legjislacionit tregtar në fuqi.

26.1.2 Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjëse për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë nga data e lëshimit të Çertifikatës së Testimit.

26.1.3 Një kopje e aktit të themelimit dhe/ose statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, i është dorëzuar Autoritetit Kontraktues përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.

26.2 Ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të Shoqërisë Koncesionare si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të kuotave të shoqërisë te palët e treta, nuk mund të zbatohet pa miratimin e autoritetit kontraktues dhe të Ministrisë së Financave, përveç se nëse ky është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të

rregulluar të kapitalit.

26.3 Shoqëritë Spitali Amerikan dhe Evita në cilësinë e ortakëvetë shoqërisë koncesionare do të mbështesin plotësisht dhe do të jenë të përfshira në vënien në jetë të Koncesionit nga Shoqëria Koncesionare përgjatë gjithë Periudhës së Koncesionit, me qëllimin e vetëm që të bëjnë të mundur:

(i) sigurimin e burimeve të nevojshme (përfshirë edhe ato financiare), ekspertizës, teknologjisë dhe njohurive;

(ii) ekspertëve për çështje parësore të punësuar nga Shoqëritë Grup të tyre;

(iii) mbështetjen e vazhdueshme për Shoqërinë Koncesionare;

26.4 Shoqëria Koncesionare e krijuar për qëllimin e këtij koncesioni do të ketë detyrimin te paguajë qiranë per ambientet brenda spitaleve rajonale të Shkodrës dhe Vlorës për sipërfaqe të marrë në shfrytëzim, me qëllim realizimin e objektit të kësaj kontrate sipas përcaktimeve VKM nr. 54, datë 05.02.2014, i ndryshuar.

27. Mirëmbajtja dhe riinvestimi.

27.1 Koncesionari deklaron se do të mirëmbajë dhe do të riinvestojë gjatë periudhës koncesionare ato sisteme të cilat paraqesin një nevojë të arsyeshme për të punuar në kushte normale pune. Riinvestimi do të kryhet në përputhje me parashikimet e Aneksit 7 (Çështje Financiare).

27.2 Riparimi dhe zëvendësimi i përbërësve apo njësive me defekt do të sigurohet pa pagesë për të gjithë kohëzgjatjen e Periudhës së Koncesionit. Të gjitha veprimet për mirëmbajtjen e Shërbimeve kanë për synim që të ruajnë operativitetin e Sistemit, duke i korresponduar përcaktimeve të hollësishme mbi performancën të përcaktuara në Anekset 2, 3 dhe/ose 4 në rast se zbatohet. Koncesionari do të sigurojë përditësimet e të gjitha programeve kompjuterike pa pagesë, duke përfshirë këtu ato në lidhje me sistemin operativ dhe me programet kompjuterike të zbatuara. Këto përditësime lidhen me modifikime që kompensojnë defekte të mundshme të gjetura gjatë operimit normal të sistemit. Këto modifikime sidoqoftë, nuk përfshijnë shtimin e veçorive të reja ekstra.

27.3 Koncesionari do të jetë përgjegjës për dëmtime që lidhen me defekte të dukshme apo të padukshme si të shërbimeve ashtu edhe të ambienteve të ndërtuara ose rinovuara nga ai sipas kërkesave te Autoritetit (Aneksi 2) si dhe propozimeve te ofruara nga ana e tij në Aneksin 3 ose Aneksin 4 në rast se zbatohet, të pajisjeve mjekësore mjeteve logjistike mjekësore dhe jo mjekësore të siguruara prej tij në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate Koncesioni. Ai nuk është përgjegjës për dëmtimet e ndryshme, humbjet ose vjedhjet që vijnë si pasojë e mospëmbushjes së detyrimeve të Autoritetit Kontraktor.

28. Shëndeti dhe siguria.

Koncesionari deklaron se ai do të veprojë në përputhje me të gjitha rregullat statutore të zbatueshme lidhur me shëndetin dhe sigurinë.

29. Barazia dhe Diversiteti.

Koncesionari do të veprojë, dhe do të sigurohet që Personeli Koncesioner do të veprojë në përputhje me çdo legjislacion antidiskriminues të zbatueshëm siç mund të jetë parashikuar nga Ligji.

30. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale.

Kjo Kontratë nuk përcakton ndonjë të Drejtë të Pronësisë Intelektuale (IPR) të secilës palë ose të licensuarve të tyre përkatës që ekziston para ose në Datën e fillimit të afatit te Koncesionit dhe për mënjanimin e dyshimit, përveç sa është paraqitur shprehimisht në këtë Kontratë:

30.1.1 Autoriteti nuk do të pretendojë ndonjë të drejtë, titull ose interes ndaj Programeve kompjuterike të Palëve të treta që Koncesionari i ka në përdorim sipas licencës përkatëse, dhe

30.1.2 Koncesionari nuk do të pretendojë ndonjë të drejtë, titull ose interes ndaj IPR-ve të Autoritetit.

31. Licencat e dhëna nga Koncesionari.

Brenda kushteve të përcaktuara ne Nenin 31.2, Koncesionari me anën e kësaj Kontrate garanton se do të autorizojë dhe do t'i transferojë Autoritetit licencën e përdorimit, të transferueshme, të gjithanshme, të lirë, joekskluzive për të përdorur Programin kompjuterik të Palëve të Treta, për aq sa Autoriteti do të paguajë, nëse ka, kostot e lidhura me të, duke përfshirë, por pa u kufizuar:

31.1.1 Të drejtën për të nënliçensuar për sa më lart, për Koncesionarin Zëvendësues ose për çdo palë tjetër të tretë që siguron këto shërbime për Autoritetin; dhe

31.1.2 Të drejtën për të caktuar dhe transferuar licencën tek një organ pasardhës që kryen funksionet e Autoritetit.

32. Licencat e dhëna nga Autoriteti.

32.1 Autoriteti i jep Koncesionarit një licencë të përkohshme, joekskluzive, të patransferueshme, të vazhduar/royalty-free, gjatë kohëzgjatjes së kontratës vetëm në masën që Autoriteti quan të nevojshme për kryerjen e shërbimeve për të përdorur:

32.1.1 Bazën e të dhënave të Autoritetit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate;

32.1.2 Dokumentacionin, proceset dhe procedurat e Autoritetit;

32.1.3 Të Dhënat e Autoritetit; dhe

32.1.4 Çdo IPR tjetër të Autoritetit që lidhet me Shërbimet, objekt i kësaj Kontrate Koncesioni.

32.2 Licenca e dhënë Koncesionarit:

32.2.1 përfshin të drejtën për të dhënë nënlicenca ndaj Nënkontraktorëve, me kushte jo më të favorshme se sa licenca e dhënë nga Koncesionari sipas Nenit 32.1 me kusht që çdo Nënkontraktor përkatës ka qenë aprovuar nga Autoriteti në përputhje me Nenin 20.1 dhe ka hyrë në një detyrim për konfidencialitet me Koncesionarin me të njëjtat kushte siç janë përcaktuar në Nenin 43 (Konfidencialiteti); dhe

32.2.2 jepet tërësisht deri në shkallën që Autoriteti e konsideron të nevojshme për të kryer Shërbimet në përputhje me këtë Kontratë. Koncesionari nuk do të përdorë, dhe do të garantojë e sigurojë që Nënkontraktori nuk do të përdorë, materialet e licencuara të identifikuara në Nenin 32.1 për çdo qëllim tjetër ose për interes/përfitim të ndonjë personi tjetër përveç se Autoritetit.

32.3 Asnjëra Palë nuk do të ketë ndonjë të drejtë për të përdorur ndonjë nga emrat e Palës tjetër, logot ose markat e shitjes ose ndonjë prej produkteve të tij pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

32.4 Në rast të zgjidhjes ose mbarimit të kësaj Kontrate, referuar Nenit 49, çdo nënlicencë e dhënë në përputhje me Nenin 32.2 do të ndërpritet automatikisht dhe Koncesionari do të dorëzojë menjëherë tek Autoriteti të gjitha materialet e dhëna me nënlicencë tek Koncesionari ose Nënkontraktorët e tij sipas Neneve 32.1 ose 32.2, nën pronësinë ose kontrollin e Koncesionarit ose Nënkontraktorit, sipas zgjedhjes së vetë Autoritetit, të shkatërrojë materiale të tilla të licensuara në përputhje me çdo instruksion të lëshuar nga Autoriteti në atë kohë, një shkatërrim i cili do të vërtetohet me shkrim nga përfaqësuesit e Koncesionarit tek Autoriteti menjëherë pas këtaj.

33. Përcaktimi i IPR-ve në Bazën e të Dhënave.

33.1 Me anën e kësaj Koncesionari i kalon Autoritetit, titullin dhe të gjithë te drejtat dhe interesin në Bazën e të Dhënave duke përfshirë të gjitha të drejtat e Pronësisë Intelektuale.

33.2 Përcaktimi sipas këtij neni do të bëhet i vlefshëm në Bazën e të Dhënave ose si një përcaktim i ri i të drejtave në të ardhmen që do të bëhen të vlefshme menjëherë sapo të bëhet ekzistuese Baza e të Dhënave, kur të jetë e përshtatshme.

33.3 Koncesionari do të tërhiqet ose autorizojë heqjen pa kushte dhe të parevokueshme të të gjithë të drejtave morale të së drejtës së autorit që janë të përfshira në Bazën e të Dhënave të përcaktuara për Autoritetin sipas kësaj Kontrate.

33.4 Pa paragjykuar Nenin 61, në qoftë se do të kërkohet nga Autoriteti, Koncesionari menjëherë do të përmbushë të gjitha dokumentat pa ndonjë tarifë ndaj Autoritetit dhe të bëjë veprime të tilla të mëtejshme (ose të autorizojë përmbushje të tillë ose veprime të tilla) nëse Autoriteti mund të kërkojë të perfeksionojë përcaktimin sipas - dispozitave të kësaj kontrate.

34. Përcaktimi i IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe i Programeve kompjuterike të Shkruar Posaçërisht

34.1 Në fund të Periudhës së Koncesionit, Koncesionari i jep Autoritetit, nëse ka, titullin dhe të gjitha të drejtat dhe interesin mbi IPR-të e Posaçme të Projektit dhe Programin kompjuterik që mund të jetëshkruar posacërisht duke përfshirë të gjitha të drejtat e Pronësisë Intelektuale në të ose do të sigurojë që pronari i parë i IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe Programit kompjuterik të shkruar posaçërisht t'i japë ato Autoritetit mbi të njëjtat baza.

34.2 Caktimi sipas këtij neni do të hyjë në fuqi në datën e mbarimit të Periudhës së Koncesionit.

34.3 Koncesionari autorizon heqjen pa kushte dhe të parevokueshme të të gjithë të drejtave morale për çdo të drejtë të autorit të përfshira në IPR-të e Posaçme të Projektit të përcaktuar për Autoritetin sipas kësaj Kontrate.

34.4 Pa paragjykuar Nenin 59 (**Pavlefshmëria e pjesshme**), nëqoftese do të kërkohet të veprohet kështu nga Autoriteti, Koncesionari menjëherë pa ndonjë tarifë ndaj Autoritetit do të nënshkruajë të gjithë dokumentat dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të hollësishme (ose të autorizojë kryerjen e veprime të tilla) siç mund t'i kërkojë Autoriteti, për të perfeksionuar përcaktimin sipas kësaj kontrate.

34.5 Përveç të drejtave të licencës të përcaktuara në Nenin 32, Autoriteti do t'i japë Koncesionarit në çdo rast me pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit një licencë joekskluzive dhe të transferueshme të IPR-ve të Posaçme të Projektit dhe Programit kompjuterik të shkruar posaçërisht për të mundësuar krijimin e punëve për klientët e tjerë.

35. Të dhënat e Autoritetit.

35.1 Koncesionari nuk do të fshijë apo heqë çfarëdo deklaratë mbi pronësinë që përmbahen brenda apo në lidhje me të Dhënat e Autoritetit.

35.2 Koncesionari nuk do të ruajë, kopjojë, përhapë apo përdorë të Dhënat e Autoritetit përveçse kur janë të nevojshme për përmbushjen nga ana e Koncesionarit të

detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate gjatë Afatit të kësaj Kontrate apo siç është autorizuar ndryshe shprehimisht me shkrim nga Autoriteti.

35.3 Në masën që të Dhënat e Autoritetit ruhen dhe/ose përpunohen nga Koncesionari, Koncesionari do të transferojë këto të Dhëna të Autoritetit te ky i fundit siç do të kërkohet sipas formatit të përcaktuar me hollësi në Aneksin 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Aneksin 3 (Propozimi i Koncesionarit) ose Aneksin 4 në rast se zbatohet.

35.4 Koncesionari do të ndërmarrë gjithë masat parandaluese të nevojshme për të ruajtur integritetin e të Dhënave të Autoritetit si edhe për të parandaluar çfarëdo prishje apo humbje të të Dhënave të Autoritetit gjatë çfarëdo mbledhje, procesimi, ruajtje dhe transmetimi nga Koncesionari.

35.5 Koncesionari do të sigurojë që çdo sistem mbi të cilin Koncesionari mban çfarëdolloj të Dhënash të Autoritetit, duke përfshirë të dhënat mbështetëse, është një sistem i sigurtë që përputhet me Aneksin 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Aneksin 3 (Propozimi i Koncesionarit) ose Aneksin 4 të kësaj Kontrate në rast se zbatohet.

36. Mbrojtja e të Dhënave Personale.

36.1 Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas kësaj Kontrate, Palët janë dakord që Autoriteti është pronar dhe kontrollues i të Dhënave Personale dhe që Koncesionari është duke proçesuar të Dhëna Personale në emër të Autoritetit.

36.2 Koncesionari:

36.2.1 do të procesojë të Dhënat Personale vetëm në përputhje me udhëzimet nga Autoriteti (të cilat mund të jenë udhëzime të posaçme apo udhëzime të një natyre të përgjithshme siç përcaktohen në këtë Kontratë ose siç janë njoftuar ndryshe nga Autoriteti ndaj Koncesionarit gjatë Afatit);

36.2.2 do të procesojë të Dhënat Personale vetëm në masën, e në një mënyrë të tillë, siç është e nevojshme për sigurimin e Shërbimeve ose siç kërkohet nga Ligji apo çdo organ rregullues;

36.2.3. do të vërë në jetë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të mbrojtur të Dhënat Personale kundër procesimit të paautorizuar apo të paligjshëm si edhe kundër humbjes aksidentale, shkatërrimit, dëmtimit, ndryshimit apo përhapjes. Këto masa do të jenë të përshtatshme për të parandaluar dëmin i cili mund të vijë si rrjedhojë nga procesimi i paautorizuar apo i paligjshëm, humbja aksidentale, shkatërrimi apo dëmtimi ndaj të Dhënave Personale dhe duke patur parasysh natyrën e të Dhënave Personale të cilat janë për t'u mbrojtur.

36.2.4. do të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar seriozitetin dhe profesionalizmin e cilitdo nga Personeli i Koncesionarit që do të ketë hyrje në të Dhënat Personale;

36.2.5 konsiderohet se ka marrë pëlqimin paraprak nga Autoriteti me qëllim që të transferojë të Dhënat Personale ndaj cilitdo Nënkontraktor apo filial për sigurimin e Shërbimeve dhe vetëm për qëllim të Shërbimeve, me kusht që nënkontraktorët t'i jenë njoftuar Autoritetit sipas Nenit 20;

36.2.6 do të sigurojë që i gjithë Personeli i Koncesionarit të cilit i kërkohet të ketë hyrje në të Dhënat Personale të jetë i informuar për natyrën konfidenciale të të Dhënave Personale dhe të përputhet me detyrimet e përcaktuara në këtë Nen;

36.2.7 do të sigurojë që asnjë person nga Personeli i Koncesionarit të mos publikojë, përhapë apo shpërndajë çfarëdo të Dhëne Personale ndaj cilësdo pale të tretë përveçse kur është i urdhëruar me shkrim për të vepruar kështu nga Autoriteti;

36.3 Koncesionari do të veprojë në çdo kohë në përputhje me legjislacionin mbi Mbrojtjen e të Dhënave dhe nuk do t'i përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate në atë mënyrë që Autoriteti të shkelë cilëndo nga detyrimet e zbatueshme të tij sipas legjislacionit mbi Mbrojtjen e të Dhënave.

37. Detyrime të Posaçme të Autoritetit.

37.1 Autoriteti do të jetë përgjegjës për sigurinë e ambienteve në 5 Qendrat ku do të ofrohet shërbimi i dializës duke mundësuar ruajtjen e pajisjeve të nevojshme për ofrimin e Shërbimeve sipas një niveli të njëjtë sigurie që ai zbaton për pajisjet e tij. Ai është gjithashtu përgjegjës për dorëzimin e ambienteve të lira nga çdo barrë ose pretendim i palëve të treta, dhe për gjendjen e tyre strukturore dhe të sigurtë.

37.2 mosfunksionimi në mënyrën e duhur të pajisjeve mjekësore për shkak të amortizimit të tyre në kushte normale pune nuk do të jetë përgjegjësi e Autoritetit por e Koncesionarit, i cili do të marrë të gjithë masat e nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e tyre brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga momenti i konstatimit të mosfunksionimit.

37.3 Eshtë kategorikisht i ndaluar përdorimi i pajisjeve dhe materialeve mjekësore të Koncesionarit nga personeli i spitaleve rajonale ku janë ngritur 5 qendrat e ofrimit të hemodializës për çfarëdo qëllimi të ndryshëm nga ai për të cilin janë destinuar të përdoren ato. Në rast se konstatohen veprime të tilla, atëherë Koncesionari do të njoftojë Autoritetin, i cili do të konsiderohet përgjegjës për dëmet e ardhura si pasojë e shkeljes së kësaj pike, për marrjen e menjëhershme të çdo mase të përshtatshme për rregullimin e kësaj situate.

37.4 Autoriteti angazhohet se do të njohë dhe do të pranojë çdo penalitet ose çdo dëm kontraktor apo jashtëkontraktor që rezulton nga kjo Kontratë, nga veprime apo mosveprime me faj të Autoritetit dhe/ose përfaqësuesve të tij, dhe do të kryejë

shpërblimin e dëmit atëherë dhe deri në masën në të cilën vërtetohet dëmi i Koncesionarit sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Civil në lidhje me shpërblimin e dëmit.

37.5 Autoriteti do të sigurojë dhe do të bëjë të gjithë përpjekjet e mundshme për të garantuar një furnizim të pandërprerë të energjisë elektrike në 5 qendrat e ofrimit të shërbimit të hemodializës pranë Spitaleve Rajonale të Shkodrës, Lezhës, Vlorës, Elbasanit, Korçës.

37.6 Autoriteti do të nënshkruajë të gjithë Çertifikatat e Testimit brenda 5 ditëve pune pas plotësimit të suksesshëm të provave të Testimit dhe do të mundësojë lëshimin e menjëhershëm të licencës për kryerjen e shërbimit.

37.7 Garanton kryerjen e pagesës prej Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

38. **Detyrime të Përgjithshme të Autoritetit.**

38.1 Autoriteti do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të asistuar dhe/ose mundësuar hartimin dhe miratimin e çdo dokumenti, udhëzimi, vendimi, urdhri apo ndonjë akti tjetër me karakter të detyrueshëm për të mundësuar vënien në funksionim të këtij Projekti dhe zbatimin e tij në mënyrë të pandërprerë duke u konsultuar edhe me Koncesionarin me qëllim mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e Projektit. Autoriteti do të marrë në konsideratë propozime të Koncesionarit për të hartuar dhe miratuar të gjitha apo ndonjë nga aktet e përmendura në këtë paragraf brenda një periudhe 5 ditore nga data e propozimit dhe nëse gjykon se një akt i tillë duhet miratuar, Autoriteti do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të mundësuar miratimin e këtij akti sa më shpejt të jetë e mundur.

38.2 Duke iu nënshtruar parashikimeve të Nenit 38.1, Koncesionari nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për vonesat e shkaktuara në ofrimin e Sherbimeve apo të mospërmbushjes së një apo më shumë detyrimeve të parashikura në këtë Kontratë, nëse megjithë përpjeket e tij për të kërkuar ndaj Autoritetit për të hartuar dhe miratuar cdo dokument, udhëzim, vendim, urdhër apo ndonjë akt tjetër me karakter të detyrueshëm për të mundësuar vënien në funksionim të këtij Projekti, ky i fundit nuk i ka marrë në konsideratë apo i ka hartuar dhe miratuar ato me vonesë.

38.3 Duke iu nënshtruar parashikimeve të Nenit 38.1, Autoriteti do të sigurojë që të paktën një përfaqësues i tij do të veprojë në çdo kohë për të mundësuar përcjelljen e çdo kërkese të Koncesionarit në lidhje me procedimet e kërkuara.

38.4 Autoriteti do të sigurojë që Koncesionari të furnizohet me të dhëna dhe informacione me rëndësi për plotësimin e detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate dhe/ose që kërkohet për qëllimin e menaxhimit, operimit dhe zhvillimit të Kontratës dhe të informojë Koncesionarin mbi çdo ndryshim apo shtim dhe të sigurojë kopje të të dhënave dhe informacioneve të tilla për Koncesionarin siç mund të kërkohet në

mënyrë të arsyeshme;

39 Plani i Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda

39.1 Palët do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Planit të Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda dhe Koncesionari do të sigurojë që është i aftë të vërë në jetë Planin e Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda në përputhje me termat / afatet e tij. Plani i Rimëkëmbjes nga Dëmtimet e Rënda do të përfundohet nga Koncesionari brenda 3 muajsh nga Data e fillimit të afatit të Koncesionit.

40 Forca Madhore – *Force Majeure*

40.1 **"Rast i Forcës Madhore"** do të thotë çdo rrethanë apo ngjarje që në mënyrë objektive është tej parashikimit dhe kontrollit absolut, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të Palës së cënuar (**"Pala e Cënuar"**)e cila shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të Palës së Cënuar për të përmbushur ndonjë apo të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, por vetëm nëse dhe në masën që:

i) kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohej apo nuk ishte e mundur të parandalohej, shmangej ose mënjanohej nga Pala e Cënuar;

ii) Pala e Cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;

iii) ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, dhe

iv) Pala e Cënuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër ("Pala e Pacënuar").

40.2 Rastet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e shprehura në përkufizimin e Rastit të Forcës Madhore më sipër:

i) veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, ose aktet e 2terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;

ii) aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;

iii) rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;

iv) epidemitë ose murtaja; dhe

v) çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të

ngadalësuar punën.

vi) Gjatë periudhës së rehabilitimit dhe/ose ndërtimit të qendrave shëndetësore, ekzistenca e temperaturave të ulëta, shirave ose kushteve atmosferike të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e rehabilitimit/ndërtimit konsiderohen si ngjarje e Forcës madhore.

Pala e Cënuar do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve dhe nuk do të konsiderohet në mospërmbushje të Kontratës për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia për të përmbushur detyrimet. Njëkohësisht, Periudha e Koncesionit do të shtyhet automatikisht për aq sa do të zgjasë Ngjarja e Forcës Madhore.

Palët në këtë Kontratë pas përfundimit të forcës madhore dhe brenda një afati 3 mujor do të sigurojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate apo rivënien në jetë të shërbimeve, duke mbajtur secila palë detyrimet dhe shpenzimet përkatëse sipas kësaj kontate.

41 Dëmshpërblimi.

41.1 Autoriteti.

Autoriteti do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe ruajë Koncesionarin të pacënuar nga ndonjë dhe çdo procedim, veprim, pretendim të palës së tretë për humbje, dëm dhe shpenzim të çfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Autoritetit, zyrtarëve, nëpunësve dhe agjentëve të tij, të ndonjë detyrimi të Autoritetit sipas kësaj Kontrate, përveçse në shkallën që një pretendim i tillë ka lindur për shkak të shkeljes nga Koncesionari të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

41.2 Koncesionari.

Koncesionari do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe ruajë Autoritetin të pacënuar nga dhe kundër çdo procedimi, veprimi, pretendimi të palës së tretë për humbje, dëm, dhe shpenzim të çfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Koncesionarit, nëpunësve, nëpunësve të afërt dhe agjentëve të tij, të çdo detyrimi të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, përveçse në shkallën që kjo humbje ose ky dëm lind nga shkelja e ndonjë dispozite të shprehur të kësaj Kontrate nga Autoriteti;

41.3 Pakësimi i Humbjes.

Pala që shkakton një shkelje të kësaj Kontrate do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të pakësuar humbjen, dëmin që ka ndodhur, me kusht që pakësimi i humbjes ose lehtësimi i dëmit të mund të bëhen pa vështirësi ose kosto të paarsyeshme.

42 Konfidencialiteti.

42.1 Përveçse në shkallën e përcaktuar të këtij Neni ose kur përhapja e informacionit lejohet shprehimisht diku tjetër në këtë Kontratë, secila Palë:

42.1.1. Do të trajtojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër si konfidencial dhe ruajë atë në mënyrën e duhur; dhe

42.1.2 Nuk do të përhapë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër asnjë personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të zotëruesit.

42.2 Dispozita e mësipërme nuk do të zbatohet në shkallën që:

42.2.1 Ky informacion ka qënë në zotërim të Palës që bën përhapjen pa detyrimin e konfidencialitetit para përhapjes së tij nga zotëruesi i informacionit;

42.2.2 Ky informacion ishte përftuar nga një palë e tretë pa detyrimin e konfidencialitetit;

42.2.3 Ky informacion ka qënë për përdorim publik në kohën e zbulimit; ose

42.2.4 Është zhvilluar në mënyrë të pavarur, pa akses në Informacionin Konfidencial të Palës tjetër.

42.2.5 Një informacion i tillë është i detyrueshëm për t'u nxjerrë sipas ligjit.

42.3 Koncesionari mund të përhapë Informacionin Konfidencial të Autoritetit vetëm Personelit të Koncesionarit që është i përfshirë drejtpërdrejt në sigurimin e Shërbimeve dhe që ka nevojë të dijë informacionin dhe do të sigurojë që ky Personel i Koncesionarit të ndërgjegjësohet dhe të përmbushë këto detyrime në lidhje me konfidencialitetin.

42.4 Koncesionari nuk do të përdorë Informacion Konfidencial të Autoritetit dhe do të sigurojë që Personeli i Koncesionarit të mos përdorë Informacion Konfidencial të Autoritetit, të marrë për qëllime të ndryshme nga ato të kësaj Kontrate.

42.5 Koncesionari ndërmerr (përveçse kur mund të kërkohet nga Ligji ose me qëllim udhëzimin e konsulentëve profesioniste në lidhje me këtë Kontratë) të mos:

42.5.1 Përhapë ose lejojë përhapjen e ndonjë detaji të kësaj Kontrate për median e lajmeve ose ndonjë pale të tretë përveç Nënkontraktorëve;

42.5.2 Përdorë emrin e Autoritetit dhe ose markën në ndonjë promocion ose marketing ose shpallje të urdhrave, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

42.6 Kjo Kontratë nuk pengon Autoritetin të përhapë Informacionin Konfidencial të Koncesionarit:

42.6.1 Ndaj cilitdo enti qeveritar. Të gjitha entet qeveritare që marrin këtë Informacion Konfidencial do të kenë të drejtë t'ia japin më tej Informacionin Konfidencial departamenteve të tjera qeveritare, mbi bazën e konfidencialitetit dhe të mos i jepet një pale të tretë që nuk është pjesë e departamentit qeveritar ose e një Autoriteti të cilët i nënshtrohen detyrimit për konfidencialitetin.

42.6.2 Mbi bazën e "nevojës për njohuri" nga konsulenti, kontraktori ose ndonjë person tjetër i angazhuar nga Autoriteti me kusht që një person i tillë të bjerë dakord që ta ruajë këtë informacion si konfidencial;

42.6.3 Mbi bazën e "nevojës për njohuri", për qëllim të shqyrtimit dhe vërtetimit të llogarive të Autoritetit.

42.7 Autoriteti do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që çdo departament qeveritar, punonjës, palë e tretë ose Nënkontraktor të cilit i jepet Informacioni Konfidencial i Koncesionarit sipas Nenit 42.6 të ndërgjegjësohet për detyrimet e konfidencialitetit të Autoritetit.

43 Kufizimet në Përgjegjësi

43.1 Asnjë Palë nuk e kufizon përgjegjësinë e saj për:

43.1.1 Vdekjen ose plagosjen personale të shkaktuar nga neglizhenca e saj ose nga neglizhenca e punonjësve, agjentëve ose Nënkontraktorëve të saj (nëse është e zbatueshme); ose

43.1.2 Mashtrimin nga ana e saj ose nga punonjësit e saj.

43.2 Duke marrë në konsideratë mënyrën e funksionimit të këtij Projekti, Përgjegjësia e Koncesionarit është e pakufizuar për të gjitha ose për secilin prej rasteve të mëposhtme:

43.2.1 Përdorimi në mënyrë të papërshtatshme të pajisjeve, materialeve dhe mjeteve mjekësore dhe jomjekësore nga personeli i të 5 qendrave ku ofrohet shërbim i hemodializës, për përdorimin e pajisjeve mjekësore dhe jo mjekësore të siguruara nga ai në përmbushje të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate Koncesioni, që sjell si pasojë mbledhje dhe/ose përpunim të dhënash mjekësore të gabuara dhe/ose te pasakta, me përjashtim të rasteve kur këto të dhëna të gabuara dhe/ose të pasakta vijnë si pasojë e një difekti ose vesi të fshehur të këtyre pajisjeve, materialeve dhe mjeteve mjekësore dhe jomjekësore ose kur janë rrjedhojë e të dhënave të pasakta që Autoriteti i ka transferuar Koncesionarit (si psh. kartelë mjekësore me gabime ose e pasaktë);

43.2.2 Përdorimi në mënyrë të papërshtatshme të mjeteve mjekësore nga personeli i të 5 qendrave ku ofrohet shërbim i hemodializës, të tilla që ndryshojnë rezultatin e analizave përkatëse për një apo më shumë persona, që sjellin si pasojë një dëm ndaj këtyre personave;

43.2.3 Pretendimi i Palëve të Treta për ndonjë dëm të mundshëm që ka ardhur si pasojë e veprimeve me faj të Koncesionarit apo të punësuarve prej të tij, do të jetë nën përgjegjësinë e plotë të Koncesionarit.

43.2.4 Kufijtë financiarë.

Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve sipas kësaj kontrate nga ndonjëra prej palëve në këtë Kontratë, dëmshpërblimi përkatës do të rregullohet sipas dispozitave të kësaj Kontrate dhe rregullave të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë në rast se kjo Kontratë nuk parashikon ndryshe.

Në rastin e përgjegjësisë profesionale, janë të zbatueshme dispozitat që i përkasin fushës së sigurimeve në Republikën e Shqipërisë, ndërsa në lidhje me penalitetet palët do t'i referohen legjislacionit në fuqi.

44 Sigurimi.

44.1 Koncesionari do të nxjerrë dhe mbajë ose do të sigurojë mbajtjen e Sigurimeve në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

45 Detyrimet për Burime, Licencë dhe Bashkëpunim të Koncesionarit

45.1 Koncesionari:

45.1.1 Do të marrë dhe do të sigurojë të gjitha burimet financiare, teknike dhe njerëzore të mjaftueshme për të realizuar Shërbimin në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate;

45.1.2 Do të marrë dhe ruajë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate të gjitha miratimet, licencat, dhe lejet (e ligjshme, rregullatore, kontraktuale apo të tjera) që mund të kërkohen dhe që janë të nevojshme për të mundësuar dhënien e Shërbimit; si dhe

45.1.3 Do t'i ofrojë Autoritetit bashkëpunimin dhe informacionin (përfshirë çdo dokumentacion) të nevojshëm, këshilla dhe asistencë në lidhje me Shërbimet dhe Sistemin me qëllim mundësimin e krijimit dhe mirëmbajtjes nga çdo person të ndërfaqeve teknike apo organizative të Shërbimeve dhe Sistemit dhe, me zgjidhjen/mbarimin e kësaj Kontrate për çfarëdo lloj arsyeje, mundësimin e kalimit në kohën e duhur të Shërbimeve (apo të çdo pjese të tyre) tek Autoriteti.

46 Garancitë.

46.1 Autoriteti.

Autoriteti deklaron dhe garanton se, që nga data e kësaj Kontrate dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:

46.1.1 Ai ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;

46.1.2 Kjo Kontratë përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj;

46.1.3 Pasuritë/Asetet që lidhen me zbatimin e Konçesionit në pronësi të Autoritetit janë dhe do të mbeten të lira nga të drejtat e palëve të treta, gjatë të gjithë Periudhës së Koncesionit;

46.1.4 Do të mbrojë dhe nuk do të dëmtojë Koncesionarin nga të gjitha pretendimet e palëve të treta në lidhje me përdorimin e qetë të vendeve dhe aseteve të Koncesionit;

46.1.5 Ai ka marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme për të lidhur dhe nënshkruar këtë Kontratë;

46.1.6 Nënshkrimi, realizimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nuk krijon konflikte, nuk rezulton në shkelje dhe nuk përbën kundërvajtje apo përshpejton realizimin që kërkohet nga çfarëdo kushti i ligjeve në fuqi apo Kontratave, konventave, VKM, dekreteve apo urdhrave tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado pronë apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim.

46.2 Koncesionari.

Koncesionari deklaron dhe garanton se, që nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:

Shoqëria Koncesionare:

46.2.1 Është organizuar rregullisht dhe ekziston ligjërisht si shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar;

46.2.2 Kjo Kontratë përbën detyrimin e saj ligjor, të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj.

46.2.3 Ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet e kësaj Kontrate dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;

46.2.4 Ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme dhe ka ndërmarrë veprime të tjera sipas ligjeve në fuqi si dhe dokumentet ligjore për të miratuar ekzekutimin, realizimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate.

46.2.5 Ka pozitën dhe kapacitetin financiar për të ndërmarrë dhe përmbushur Koncesionin;

46.2.6 Do të identifikojë Palët e Treta që do të sigurojnë një pjesë të Shërbimeve, objekt i kësaj Kontrate si edhe shërbimet e siguruara prej tyre.

46.2.7 Do të njoftojë Autoritetin mbi çdo kontroll auditimi që do ketë impakt në Shërbimet, objekt i kësaj Kontrate;

46.2.8 Do të përmbushë detyrimet e saj me seriozitetin dhe angazhimin e duhur profesional.

47 Siguria e Sistemit

47.1 Koncesionari do të përmbushë dhe do të autorizojë përmbushjen nga Personeli i Koncesionarit të politikave të tij të sigurisë.

47.2 Autoriteti duhet të njoftojë Koncesionarin për çdo ndryshim apo ndryshime të propozuara në politikat e sigurisë.

47.3 Nëse Koncesionari beson se ndryshimi apo ndryshimi i propozuar në politikat e sigurisë do të ketë ndikim të rëndësishëm apo kosto të pashmangshme tek Shërbimet, ai do të paraqesë një Kërkesë për Ndryshim. Në këtë rast, përveç elementëve të parashikuar në këtë kontratë lidhur me ndryshimin, Koncesionari duhet të mbështesë kërkesën e tij duke dhënë fakte të shkakut të rritjes së kostove dhe hapat që ai ka ndërmarrë për të zbutur (zvogëluar) këto kosto. Çdo ndryshim në Çmim duhet më pas të miratohet në përputhje me Proçedurën e Kontrollit të Ndryshimit.

47.4 Deri dhe/ose përveçse në rast të miratimit të një ndryshimi në Çmim nga Autoriteti sipas Nenit 3.3, Koncesionari duhet të vazhdojë të kryejë Shërbimet në përputhje me detyrimet e tij ekzistuese.

47.5 Trajnimi i Personelit

Koncesionari do të realizojë trajnime të vazhdueshme për të gjithë personelin e Koncesionarit, të cilët janë punësuar apo angazhuar në kryerjen e Shërbimeve në përputhje me Politikën e Sigurisë.

47.6 Programe kompjuterike të dëmshme.

47.6.1 Koncesionari do të sigurojë vlefshmërinë e sistemeve software dhe hardware si edhe të ndryshimeve/përditësimeve të tyre. Menaxhimi i programit kompjuterik do të jetë pjesë e planit të projektit sipas parashikimeve të nenit 4.

47.6.2 Si detyrim i vazhdueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes, Koncesionari do të përdorë versionet më të fundit të programeve antivirus që disponohen nga prodhues të njohur të industrisë informatike për të kontrolluar dhe fshirë çdo Program kompjuterik të Dëmshëm nga Sistemi.

47.6.3 Pavarësisht Nenit 47.6.1, nëse evidentohet një Program kompjuterik i Dëmshëm, Palët do të bashkëpunojnë për të zvogëluar efektin e Programit kompjuterik të Dëmshëm dhe, veçanërisht nëse Programi kompjuterik i Dëmshëm shkakton humbje të efektivitetit të punës apo humbje ose dëmtim të të dhënave të Autoriteti, do të ndihmojnë njëri-tjetrin për të zbutur humbje të tilla dhe për të rikthyer funksionimin normal në nivelin e dëshiruar.

47.7 Çdo kosto që lind nga veprimet e palëve, të cilat ndërmerren sipas dispozitave të Nenit 47.6.1, do të mbulohen nga palët si më poshtë:

47.7.1 Nga Koncesionari nëse Programi kompjuterik i Dëmshëm lind nga Programi kompjuterik i Koncesionarit, nga Programi kompjuterik i Palëve të Treta apo të Dhënat e Autoritetit (ndërkohë që të Dhënat e Autoritetit ishin nën kontroll të Koncesionarit); dhe

47.7.2 Nga Autoriteti nëse Programi kompjuterik i Dëmshëm lind nga Programi kompjuterik i Autoritetit apo të Dhënat e Autoritetit (ndërkohë që të Dhënat e Autoritetit ishin nën kontroll të Autoritetit).

48 Të drejtat dhe Detyrimet e Koncesionarit.

48.1 Të Drejtat e Koncesionarit.

Përveç të drejtave që lindin nga dhënia e Koncesionit, Koncesionari gëzon të drejtat e mëposhtme:

48.1.1 Të paguhet për kryerjen e shërbimeve të Koncesionit.

48.1.2 Të punësojë apo angazhojë punonjës, përfshirë Personelin Kryesor, me qëllim zbatimin e Koncesionit si dhe të hartojë politikën e vetë të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë Kontratë;

48.1.3 Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur Kontratën e Koncesionit, të përmbushë detyrimet e tij dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate;

48.1.4 të përmbushë detyrimet e tij lidhur me zgjatjen e Periudhës së Koncesionit në përputhje me Nenin 3.3.

48.1.5 Të zëvendësojë çdo pajisje njësie kompjuterike, programi kompjuterik, materiale dhe pajisje mjekësore të renditura në Aneksin 3 (Propozimi i Koncesionarit) ose Aneksin 4 me pajisje të barasvlefshme përsa i përket funksionimit të tyre.

48.2 Detyrime të Përgjithshme të Koncesionarit

48.2.1 Të zbatojë Koncesionin në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Shtojcat e saj;

48.2.2 Përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe në këtë Kontratë ose kur është rënë dakord ndryshe mes Palëve, Koncesionari do të mbulojë kostot dhe shpenzimet që shoqërojnë përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë Kontratë dhe Anekset e saj;

48.2.3 Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë dhe në Ligj, Koncesionari do të aplikojë dhe paguajë, marrë dhe ruajë të gjitha autorizimet, lejet dhe licencat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate;

48.2.4 Koncesionari do të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e nënkontraktorit (sipas kontratave përkatëse që mund të jenë të nevojshme) në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Anekset e saj;

48.2.5 Pas përfundimit të Periudhës së Koncesionit dhe në përputhje me dispozitat e Kontratës dhe Programit të Menaxhimit të Largimit, pajisjet mjekesore të gjitha asetet e tjera, laboratorët, mjetet mjekësore dhe jo mjekësore të vendosura vetëm në 5 qendrat e ofrimit të hemodializës të përdorura nga Koncesionari dhe/ose punonjësit e tij dhe që i përkasin Koncesionarit gjatë Periudhës së Koncesionit dhe për qëllimin e zbatimit të Koncesionit, përfshirë sistemet software dhe hardware dhe të drejtat e pronësisë intelektuale, do t'i kalojnë Autoritetit pa shpërblim.

48.3 Detyrime të Posaçme të Koncesionarit.

Koncesionari është i detyruar:

48.3.1 Të ofrojë shërbimin e hemodializës, pranë spitaleve rajonale Shkodër, Lezhë, Korçë, Elbasan, Vlorë. Rehabilitimi i hapësirave ekzistuese në Shkodër, Vlorë dhe Elbasan, përshtatja e ambienteve dhe ndërtimi i hapësirave të reja në Korçë dhe Lezhë në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në këtë Kontratë;

48.3.2 Të hartojë, vendosë, menaxhojë, mirëmbajë, operojë dhe mbikqyrë Sistemin gjatë Periudhës së Koncesionit në përputhje me kërkesat dhe afatet e parashikuara në këtë Kontratë;

48.3.3 Të sigurojë cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të Sistemit gjatë periudhës së Koncesionit;

48.3.4 Të trajnojë personelin e Koncesionarit në përputhje me kërkesat e kësaj Kontrate dhe Aneksin 3 (Propozimi i Koncesionarit);

48.3.5 Të informojë Autoritetin në çfarëdo rrethane për çfarëdo shkak që mund të dëmtojë procesin e zbatimit të Koncesionit;

48.3.6 Të raportojë çdo gjashtë muaj tek Autoriteti në lidhje me përparimin e realizuar në zhvillimin e Koncesionit dhe problematikat e konstatuara, siç përcaktohet në këtë Kontratë;

48.3.7 Të paraqesë tek Autoriteti kërkesë për ndryshim sikundër parashikohet në këtë Kontratë dhe Aneksin përkatës (11);

49 Zgjidhja.

49.1 Dispozita të përgjithshme.

49.1.1 Autoritetit, përveç rasteve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, i jepet e drejta për të zgjidhur Kontratën kur:

a. Koncesionari është në shkelje të detyrimeve thelbësore, sipas kësaj Kontrate dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, për një periudhë prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga njoftimi me shkrimi për këtë shkelje;

b. Koncesionari është në procedurë falimentimi.

49.1.2 Koncesionari, përveç rasteve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, ka të drejtë ta zgjidhë Kontratën kur Autoriteti është në shkelje thelbësore të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, për një periudhë prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga njoftimi i kësaj shkeljeje, me anë të një njoftimi me shkrim.

49.2 Zgjidhja e Kontratës për shkak të Forcës Madhore.

Nëse një Forcë Madhore vazhdon ose, me gjykimin e drejtë të Palëve, ka mundësi të vazhdojë për një periudhë me të gjatë se 6 muaj të njëpasnjëshëm, përveç dispozitave të nenit 40.1 (Pasoja e Ngjarjes së Forcës Madhore), secila Palë mund t'i japë fund menjëherë kësaj Kontrate, duke i dhënë një Njoftim Zgjidhjeje Palës tjetër.

49.3 Njoftimi i Zgjidhjes.

49.3.1 Secila nga Palët që i japin fund kësaj Kontrate në përputhje me Nenin 49 (me përjashtim të nenit 49.2 ku zgjidhja bëhet efektive sapo dorëzohet Njoftimi për

Zgjidhje), do ta bëjë këtë me anë të një Njoftimi paraprak me shkrim prej 60 ditësh, i cili i dërgohet Palës tjetër (Njoftim Zgjidhjeje). Njoftimi i Zgjidhjes duhet të përmbajë:

(i) detajet e duhura duke nënvizuar Shkakun e Zgjidhjes;

(ii) Datën e Zgjidhjes, e cila duhet të jetë jo më parë se 60 ditë nga data e Njoftimit të Zgjidhjes;

(iii) Përfundimi i Pagesës, përfshirë dhe hollësitë e llogaritjes të saj dhe;

(iv) çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

50 Pasojat e Zgjidhjes.

50.1 Në rast të përfundimit apo të mbarimit, Koncesionari duhet:

50.1.1 Të ndërpresë përdorimin e të Dhënave të Autoritetit:

50.1.2 Të jetë në përputhje me detyrimet që i përmban Plani i Daljes; dhe

50.1.3 Pas marrjes së Njoftimit të Zgjidhjes me shkrim, t'i sigurojë akses gjatë orëve të punës, Autoritetit, punonjësve të tij, agjencive dhe nënkontraktorëve dhe/ose Koncesionarëve Zëvendësues për një periudhë 30 ditore, pas mbarimit të afatit të zgjidhjes për:

50.1.3.1 informacion, në lidhje me Shërbimet, nëse ai mbetet në zotërim ose kontroll të Koncesionarit; dhe

50.1.3.2 anëtarët e personelit të Koncesionarit, meqë janë të përfshirë në dizenjimin, zhvillimin dhe përgatitjen e Shërbimeve dhe që ende janë të punësuar nga Koncesionari.

50.2 Mbarimi i afatit të Kontratës apo zgjidha e saj e parakohshme (sido që të ndodhë ajo), nuk duhet të cënojë të drejtat apo ligjshmërinë e secilës prej palëve, as edhe vazhdimësinë e ndonjë dispozite në këtë Kontratë, e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të vazhdojë të jetë në fuqi pas mbarimit të afatit të Kontratës ose zgjidhjes së parakohshme.

50.3 Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të përgjithshme mbi mënyrën e trajtimit të pasojave të zgjidhjes së Kontratës përpara afatit të saj, Palët janë dakord që:

50.3.1 Në rast të zgjidhjes së Kontratës nga ana e Autoritetit për pamundësinë e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij thelbësore të parashikuara këtu atëherë Autoriteti do të mbajë: (i) Sigurimin e Kontratës; si dhe (ii) nëse është

shkaktuar ndonjë dëm i mundshëm, ky dëm do të mbulohet nga Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale. Në këtë rast Koncesionari ka të drejtë të tërheqë të gjitha mjetet, pajisjet dhe materialet mjekësore të siguruara prej tij. Pasojat e zgjidhjes së kontratës do të rregullohen nga dispozitat përkatëse të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

50.3.2 Në rast të zgjidhjes së Kontratës nga ana e Koncesionarit për pamundësinë e Autoritetit për të përmbushur detyrimet e tij, pas datës së lëshimit të Certifikatës së Testimit, Autoriteti do t'i paguajë Koncesionarit një vlerë financiare të barabartë me vleren totale vjetore të Çmimit të Shërbimeve të ofruara shumëzim numrin e viteve që kanë mbetur deri në fund të afatit të kësaj Kontrate. Nëse kjo periudhë nuk llogaritet me vite të plota atëherë ajo do të llogaritet me bazë mujore. Kësaj vlere do t'i shtohet edhe çdo dëm i mundshëm që mund t'i shkaktohet Koncesionarit si rezultat i veprimeve të Autoritetit. Pasojat e zgjidhjes së kontratës do të rregullohen nga dispozitat përkatëse të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

50.4 Dispozitat e mësipërme nuk kufizojnë asnjërën prej palëve për të kërkuar shpërblimin e dëmit sipas legjislacionit në fuqi, në rastin kur dëmi i shkaktuar është më i madh.

51 Administrimi i Daljes.

51.1 Autoriteti dhe Koncesionari, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Administrimit të Daljes, të parashtruara në këtë Kontratë dhe me çdo Plan të Daljes.

52 Të drejtat për Ndërhyrje.

52.1 Gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, duke marrë në konsideratë rëndësinë publike të Shërbimeve, Autoriteti mund të ndërmarrë veprime të përkohshme me qëllim menaxhimin e këtij Projekti, në përputhje me këtë nen, në rrethanat e pazotësisë nga ana e Koncesionarit për të përmbushur detyrimet e tij materiale dhe kjo pazotësi nuk është rregulluar brenda 60 ditëve nga njoftimi me shkrim nga Autoriteti;

52.2 Veprimet që duhet të merren para ushtrimit të të drejtave të ndërhyrjes.

Para se Autoriteti të ushtrojë të drejtat e tij ashtu si duhet në përputhje me këtë nen, ai duhet t'i japë mundësinë Koncesionarit, për një afat prej jo më pak se 60 ditësh, t'i tregojë Autoritetit që, ai është ende i aftë për të siguruar Shërbime, në përputhje me kushtet e Kontratës dhe/ose të rregullojë rrethanat, duke dhënë të drejtën për ndërhyrje, pa kërkesën për të ndërmarrë një veprim nga ana e Autoritetit.

52.3 Nëse Autoriteti, nuk është i kënaqur me parametrat e Koncesionarit, mbështetur në parashikimin e nenit 52.2, Autoriteti mund:

52.3.1 Në rastin kur e sheh të arsyeshme dhe të përshtatshme këtë, t'i kërkojë Koncesionarit me anë të një njoftimi me shkrim, të ndërmarrë hapat që Autoriteti i konsideron të nevojshme ose të përshtatshme për të lehtësuar dhe rregulluar gjendjen e Shërbimeve dhe për t'i dhënë të drejtën Autoritetit për të hedhur hapin e duhur;

52.3.2 Caktojë një person të punojë me Koncesionarin, për të përmirësuar të gjitha ose një pjesë të Shërbimeve (përfshirë këtu dhe ata nga ndonjë palë nën-kontraktuese).

53 Sigurimi i Kontratës.

53.1 Koncesionari, me shpenzimet e tij, i ka dorëzuar Autoritetit një Sigurim Kontrate nga një shoqëri sigurimesh që operon në territorin e Republikës së Shqipërisë për një shumë të barabartë me 10% te vlerës së investimit.. Në çdo rast dhe në çdo rrethanë gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, Sigurimi i Kontratës do të mbulojë vetëm ato shifra financiare që i referohen rasteve të vonesave dhe të dëmeve të shkaktuara për faj të Koncesionarit në përmbushjen e detyrimeve të parashikura këtu. Autoriteti do t'i kthejë Sigurimin e Kontratës Koncesionarit pas kalimit të një periudhe prej 10 ditësh që nga data e mbarimit të kësaj Kontrate me kusht që Koncesionari të mos jetë në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

53.2 Formulari i Sigurimit të Kontratës do të zvogëlohet nga Koncesionari në përputhje me formulën në vijim:

53.2.1 40% pas përfundimit të Testimit të Projektit;

53.2.2 20% në përfundim të përvjetorit të tretë nga Data Efektive sipas kësaj Kontrate;

53.2.3 20% në përfundim të përvjetorit të gjashtë nga Data Efektive sipas kësaj Kontrate.

53.3 Në rastin kur Koncesionari, është në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate, pas njoftimit, Autoriteti do të ketë të drejtë, pa paragjykuar të drejtat dhe mjetet e tjera të tij të parashikuara këtu, që të kërkojë çdo shumë financiare sipas Sigurimit të Kontratës të cilën Koncesionari është përgjegjës që ta paguajë ndaj Autoritetit sipas kësaj Kontrate. Sigurimi i Kontratës nuk do të kërkohet nga Autoriteti në rastet kur ndodh Forca Madhore apo ngjarje të Pazotësisë apo Pamundësisë që prekin Autoritetin.

54 Transferimi.

54.1 Kjo kontratë e koncesionit nuk mund të transferohet te një person i tretë që nuk përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, pa miratimin paraprak me

shkrim të autoritetit kontraktor. Këto kërkesa nuk u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari /partneri privat i mëparshëm. Miratimi i Autoritetit konsiderohet i dhënë në rast se personi i tretë përmbush objektivisht kërkesat e pështatshmërisë të përcaktuara në DST.

54.2 Në çdo rast transferimi i kontratës së Koncesionit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës.

55 Çlirimi dhe rregullimet kumulative.

55.1 Të drejtat dhe rregullimet e siguruara nga kjo Kontratë mund të hiqen vetëm me shkrim nga Përfaqësuesi përkatës në një mënyrë që deklaron shprehimisht se synohet çlirimi dhe se një çlirim i tillë do të jetë në veprim vetëm në lidhje me rrethanat e pëcaktuara me hollësi e të referuara aty.

55.2 Përveçse kur një e drejtë apo rregullim i Autoritetit është e shprehur se është një e drejtë apo rregullim ekskluziv / përjashtimor, ushtrimi i saj nga Autoriteti është pa paragjykim ndaj të drejtave dhe rregullimeve të tjera të Autoritetit. Çdo mosarritje apo dështim për të ushtruar një të drejtë apo rregullim nga secila Palë nuk do të përbëjë një çlirim nga ajo e drejtë apo rregullim apo nga çfarëdo të drejtash ose rregullimesh të tjera.

55.3 Të drejtat dhe rregullimet e siguruara nga kjo Kontratë janë kumulative dhe përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, nuk janë ekskluzive / përjashtimore ndaj cilësdo të drejtë apo rregullimi të parashikuar në ligj apo parashikuar ndryshe në këtë Kontratë.

56 Marrëveshja e Palëve.

Asgjë në këtë Kontratë nuk ka për qëllim që të krijojë një ortakëri apo një marrëdhënie ligjore të çfarëdo lloji që mund të shtonte përgjegjësi mbi njërën Palë për veprimin apo mosveprimin e Palës tjetër apo që të autorizonte secilën nga Palët që të veprojë si agjente për Palën tjetër. Asnjëra nga palët nuk do të ketë autoritetin dhe/ose kompentencën që të bëjë përfaqësime apo të veprojë në emër të Palës tjetër apo të angazhojë palën tjetër në çfarëdo mënyrë.

57 Parandalimi i korrupsionit.

57.1 Koncesionari:

57.1.1 nuk do t'i ofrojë apo të bjerë dakord t'i japë cilitdo person që punon apo që është angazhuar nga Autoriteti apo cilido organ tjetër i qeverisë shqiptare çfarëdo dhurate apo gjëje të ngjashme e cila mund të shërbejë si shtysë apo si një shpërblim për çfarëdo veprimi apo mosveprimi në lidhje me këtë Kontratë, ose me çdo Kontratë tjetër ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit ose cilitdo

organ të qeverisë shqiptare, duke përfshirë këtu dhënien e kësaj kontrate ndaj Koncesionarit dhe cilësdo nga të drejtat dhe detyrimet që përmbahen në të;

57.1.2 dhe as, nuk do të futet në këtë Kontratë nëse ka njohuri se, në lidhje me të, çfarëdo shume në para është paguar apo do t'i paguhet cilitdo person që punon për apo është i përfshirë nga Autoriteti apo cilido organ tjetër i qeverisë shqiptare apo për Koncesionarin, apo se një Kontratë është arritur për këtë qëllim, përveçse kur hollësi të një Kontratë të tillë janë bërë të njohura me shkrim për Autoritetin përpara zbatimit të kësaj Kontrate.

58 Publiciteti.

58.1 Koncesionari nuk do të bëjë asnjë deklaratë për shtyp apo të publikojë këtë Kontratë apo pjesë të përmbajtjes së saj në asnjë mënyrë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit, pëlqimi i të cilit nuk do të refuzohet apo vonohet pa arsye.

59 Pavlefshmëria e pjesshme.

Nëse cilado nga dispozitat e kësaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për çfarëdo arsye dhe nga cilado gjykatë apo juridiksion kompetent, një dispozitë e tillë do të ndahet pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë e kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate gjykohet se është e pavlefshme në çfarëdo shtrirje, Koncesionari dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmëri.

60 Sigurime të mëtejshme.

Secila Palë merr përsipër të përmbushë të gjitha veprimet dhe të zbatojë të gjitha dokumentat që mund të jenë të nevojshme për t'i dhënë fuqi kuptimit të kësaj Kontrate me kërkesën dhe shpenzimet e Palës tjetër.

61 Marrëveshja si një e tërë.

61.1 Kjo Kontratë, së bashku me dokumentacionin e tenderit dhe dokumentet të cilave i bëhet referim në të, përbën Kontratën si një e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me çështjet e trajtuara në të dhe sundon mbi, zhvlerëson dhe shfuqizon çdo Kontratë apo Marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me çështje të tilla pavarësisht nga termat e cilitdo rregullim apo cilësdo Kontratë të mëparshme që kanë shprehur se nuk do të përfundojnë.

61.2 Secila nga palët njeh dhe bie dakord se me hyrjen në këtë Kontratë dhe në dokumentat e referuar në të, ajo nuk mbështetet ne asnjë kontratë apo marrëveshje të mëparshme, dhe si rrjedhim nuk do të përfitojë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë, çfarëdo deklarate, përfaqësimi, garancie apo detyrimi të marrë përsipër (qoftë e bërë nga neglizhenca apo pa faj) të ndryshme nga sa është thënë në mënyrë të shprehur në këtë

Kontratë. Rregullimi i vetëm i mundshëm për secilën palë në këtë Kontratë në lidhje me deklarime, përfaqësime, garanci apo kuptime të tilla do të jetë për raste të shkeljes së kontratës sipas termave të kësaj Kontrate.

61.3 Asgjë në këtë Nen nuk do të veprojë për të mënjanuar apo përjashtuar çdo lloj përgjegjësie me bazë mashtrimin.

62 Të drejtat e Palëve të Treta.

62.1 Duke iu dispozitave të Nenit 42 (Konfidencialiteti), një person që nuk është palë në këtë Kontratë nuk ka të drejtë të zbatojë asnjë nga termat e kësaj Kontrate por kjo nuk prek çfarëdo të drejte apo rregullimi të çdo personi i cili ekziston apo është bërë i disponueshëm në vijim të një Akti të ndryshëm nga ky.

62.2 Çfarëdo të drejtash të krijuara sipas Nenit 63 mund të ndryshohen apo përfundohen nga palët pa pëlqimin e përfituesve të palëve të treta.

63 Njoftimet.

63.1 Cilatdo Njoftime të dhëna sipas apo në lidhje më këtë Kontratë do të jenë më shkrim, të nënshkruara nga apo në emër të Palës që e bën njoftimin dhe do të njoftohet përmes dërgimit personalisht apo dërgimit të regjistruar të parapaguar apo postë të rregjistruar ose me faks në adresën dhe në vëmendjen e Palës përkatëse për këtë qëllim apo në atë adresë që Pala mund të ketë përcaktuar në përputhje me këtë Nen. Njoftimet mund të dërgohen me postë elektronike (e-mail).

63.2 Çdo Kërkesë për Ndryshim do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar.

63.3 Do të quhet se një njoftim është marrë:

63.3.1 Nëse është dërguar personalisht, në kohën e dërgimit; dhe

63.3.2 Në rast të dërgimit të parapaguar me postë të klasit të parë, tre ditë pune që nga data e postimit.

63.4 Në të provuarit e shërbimit, do të jetë e mjaftueshme të provohet se zarfi që përmbante njoftimin u dërgua në adresën e Palës përkatëse në adresat e njoftuara paraprakisht për marrjen e njoftimeve (ose siç është njoftuar ndryshe nga ajo Palë) dhe u dërgua ose në atë adresë ose në ruajtjen e autoriteteve të postës si postë e parapaguar e klasit të parë, dërgim i rregjistruar, postë e rregjistruar apo letër e dërguar me postë ajrore.

64 Gjuha dhe Kopjet.

Kjo Kontratë do të hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe në 7 kopje origjinale.

65. Ligji rregullues dhe Juridiksioni.

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së

Shqipërisë. Konfliktet do të zgjidhen së pari në pajtim me Procedurën e Zgjidhjes së Konflikteve të përcaktuar në Aneksin 10. Në rast se zgjidhja me pajtim dështon, atëherë mosmarrëveshja mes Palëve do të zgjidhet përmes Arbitrazhit, referuar rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris (ICC Rules). Vendi i Arbitrazhit do të jetë në Tiranë, ndërsa gjuha e Arbitrazhit do të jetë gjuha Angleze. Mosmarrëveshja do të gjykohet nga tre Arbitra, ku secila nga palët ka të drejtë të zgjedhë nga një Arbitër dhe arbitri i tretë do të zgjidhet sipas rregullave të ICC. Shpenzimet proceduriale në lidhje me procedurat e arbitrazhit do të merren përsipër paraprakisht nga ana e Shoqërisë Koncesionare.

NË PRANI të të cilëve kjo Kontratë është arritur siç duhet nga Palët.

NËNSHKRUAR
për dhe në emër të

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Blv. " Bajram Curri", Nr. 1, Tiranë

Nënshkrimi: Ilir Beqaj

Emri: **ILIR BEQAJ**

Pozicioni: Ministër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E SHËNDETËSISË

NËNSHKRUAR
për dhe në emër të

DiaVita sh.p.k
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Rruga Paralele, Ndërtesë Private, Kashar, Tiranë

Nënshkrimi: Marsida Hoxha

Emri: **Marsida HOXHA**

Pozicioni: Administrator i Përgjithshëm

DiaVita NIPT: L52305009L